REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА

KSHPK
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

STRATEGJIA NACIONALE PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
2021-2025

Shkup, dhjetor 2020

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Strategjia Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave me një plan veprimi për zbatimin e saj (në vazhdim: Strategjia) është një dokument i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Para se të paraqitet për miratim në Kuvend, Strategjinë e miraton Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në vazhdim: KSHPK). Ajo përfshin një periudhë prej pesë vjetësh, pra i referohet periudhës 2021-2025.

Bartës i procesit të përgatitjes së Strategjisë është KSHPK-ja. Për këtë qëllim, bazuar në një analizë të rreziqeve të korrupsionit të kryer më parë, KSHPK-ja zhvilloi një proces konsultimi të gjerë, gjithëpërfshirës dhe transparent, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat, mediave, organizatave dhe fondacioneve të shoqërisë civile, ekspertëve dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare përkatëse. Drafti i Strategjisë u vu në dispozicion të publikut për shqyrtim dhe komente, duke mundësuar kështu një konsensus të gjerë për fushëveprimin dhe përmbajtjen e saj.

Duke marrë parasysh se Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e të gjitha dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale në fushën e luftës kundër korrupsionit, parimet dhe detyrimet e këtyre dokumenteve janë plotësisht të përfshira në Strategji. Gjatë përgatitjes së Strategjisë janë marrë parasysh edhe dokumentet përkatëse nacionale dhe raportet nga organizatat ndërkombëtare që i referohen Republikës së Maqedonisë Veriore.

Vetë strategjia është hartuar në përputhje me vizionin e një shoqërie të bazuar në vlerat më të larta etike dhe integritetit, që të gjithë qytetarëve u siguron qasje të barabartë tek institucione të përgjegjshme dhe transparente dhe respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut. Realizimi i qëllimeve dhe masave të Strategjisë duhet të sigurojë ndërtimin e besimit në institucionet e sistemit, përdorimin efikas të resurseve publike dhe forcimin e demokracisë, vlerave shoqërore dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

Qëllimet kryesore të Strategjisë janë:

1) Rritja e nivelit të përgjegjësisë politike dhe gatishmërisë së demonstruar për luftë kundër korrupsionit;
2) Menaxhimi i ndërgjegjshëm i ndikimit politik në sektorin publik dhe parandalimi i ndikimit politik në punën e organeve të pavarura dhe në procedurat e rregulluara me ligj;
3) Fuqizimi i integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik;
4) Ushtrimi i kompetencave në sektorin publik në mënyrë ligjore, transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive;

5) Sigurimi i integritetit dhe transparencës së procedurës së punësimit dhe politikat e burimeve njerëzore në sektorin publik, bazuar në një sistem vlerash dhe kriteresh të cilësisë;
6) Fuqizimi i mekanizmave mbikëqyrës dhe kontrollues;
7) Dixhitalizimi i shërbimeve publike;
8) Zvogëlimi i korrupsionit në prokurimet publike dhe në procesin e dhënies së granteve, subvencioneve dhe ndihmave të tjera shtetërore;
9) Forcimi i kapaciteteve dhe angazhimi i agjencive për zbatimin e ligjit, prokurorisë dhe gjyqësorit në zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës ndaj korrupsionit në radhët e tyre.
10) Përkrahja e transparencës dhe integritetit në sektorin privat;
11) Ngritja e vetëdijes publike dhe realizimi i edukimit antikorrupsion; dhe
12) Përfshirja e shoqërisë civile dhe mediave në luftën kundër korrupsionit në shoqëri dhe sendërtimi i integritetit personal dhe profesional.

Strategjia identifikon dhe zgjedh problemet prioritare që shkaktojnë një rrezik të lartë korrupsioni, si dhe identifikon masat për t'i kapërcyer ato. Problemet dhe masat e parashikuara nga kjo strategji janë të sistemuara në fushat dhe sektorët e mëposhtëm:

Prokurimet publike. Ekziston nevoja për të forcuar kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të prokurimeve publike; forcimin e kapaciteteve të institucioneve me kuadër të kualifikuar dhe të trajnuar për kryerjen e prokurimeve publike; për rritjen e efikasitetit në realizimin e prokurimeve publike dhe rritjen e integritetit të institucioneve dhe personave të përfshirë në zbatimin e tyre, si dhe transparencën në prokurimet publike.

Punësimet në sektorin publik. Është me rëndësi të vendoset një sistem i planifikimit real i nevojave për punësime në sektorin publik, realizimi i punësimeve bazuar në parimet e kompetencës dhe sigurimi i transparencës së lartë të procedurave të punësimit. Për më tepër, është e nevojshme të përcaktohen më hollësisht kriteret për drejtorë dhe anëtarë të bordeve mbikëqyrëse dhe drejtuese në organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, në mënyrë që të sigurohet menaxhim cilësor.

Sistemi politik. Është thelbësore të sigurohet përdorimi racional i instrumentit për miratimin e ligjeve me procedurë të shkurtër në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ngritja e cilësisë së procesit të miratimit të ligjeve përmes definimit më të hollësishëm të vlerësimit të ndikimit të kornizës ligjore. Për më tepër, është e nevojshme të vendoset një sistem për forcimin e integritetit të qeverisë, si dhe rregullimi ligjor i të gjitha aspekteve të përgjegjësisë së bartësve të funksioneve. Po ashtu është e nevojshme të përcaktohen saktësisht rregullat në procesin

(para)zgjedhor, financimi i fushatave politike përmes mediave online dhe të sigurohet mbrojtje nga abuzimi i procesit parazgjedhor për punësime të reja dhe manipulime të tjera.

Gjyqësori. Po aq me rëndësi është forcimi i integritetit të faktorit njeri në gjyqësor, Prokurorisë Publike dhe Avokaturës së Shtetit, përmes trajnimeve adekuate. Gjithashtu duhet të forcohet sistemi i përgjegjësisë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, përfshirë këtu edhe transparencën e këtij sistemi. Duhet patjetër të bëhet ekipimi kadrovik i prokurorive publike, të krijohen qendra hetimore dhe të vendoset një sistem i automatizuar për delegimin dhe monitorimin e lëndëve në Prokurorinë Publike, si dhe vendosja e një sistemi transparent efikas brenda Avokaturës së Shtetit për bashkëpunim dhe komunikimin me publikun.

Organet e zbatimit të ligjit. Ky sektor përfshin të gjitha organet që kanë kompetencat për zbatimin e ligjeve. Masat përfshijnë sigurimin e një transparence maksimale të procedurave për punësim dhe avancim në karrierë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), si dhe ngritjen e efikasitetit të sistemit për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale të personave të punësuar në Policinë Financiare, MPB dhe Drejtorinë e Doganave. Për më tepër, është e nevojshme të analizohen rreziqet sistemike për korrupsion në shërbimet e inspektimit, por gjithashtu të sigurohet forcimi i kapaciteteve të inspektorateve. Ky sektor gjithashtu përfshin auditimin. Drejtuesit e institucioneve shtetërore shpesh nuk zbatojnë rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe Enti Shtetëror për Revizion (ESHR), dhe rrjedhimisht parashtrohet nevoja për të vendosur një sistem efikas të zbatimit të rekomandimeve, por edhe një sistem i përgjegjësisë. Duhet të sigurohet pavarësi objektive edhe më e madhe në zbatimin e auditimit të brendshëm, përmes aplikimit të një modeli të duhur institucional.

Shëndetësia. Në këtë sektor është me rëndësi të vendosen kritere transparente dhe të përshtatshme për përdorimin e financave publike, së bashku me dixhitalizimin dhe ndërlidhjen e ofruesve të shërbimeve shëndetësore në një sistem të përbashkët kontabiliteti financiar. Përveç kësaj, është e nevojshme të precizohet sistemi i formimit të çmimeve dhe prokurimeve publike të barnave në përputhje me praktikat dhe rregulloret në vendet e zhvilluara, si dhe të vendoset një kornizë ligjore për përzgjedhjen e barnave që mbulohen nga buxheti i shtetit dhe të sigurohet transparencë e procedurave përkatëse. Në të njëjtën kohë, duhet të specifikohen karakteristikat, kushtet dhe mënyra e pranimit të donacioneve në institucionet shëndetësore publike dhe të dhënat për këto donacione të jenë publike. Një problem tjetër është se nuk ka një monitorim efektiv të promovimit të barnave në vend, e as nuk janë të parapara instrumente specifike për menaxhimin e barnave, që e bën të domosdoshëm rregullimin ligjor në këtë fushë.

Arsimi. Korrupsioni në arsim ka format dhe rreziqet e tij të ndryshme, varësisht nga niveli. Është konstatuar se në arsimin e lartë është evident niveli i lartë i korrupsionit, që mund të vërtetohet nga vendimet e gjykatave, ndërsa në arsimin e mesëm, përveç nivelit të ulët të korrupsionit, shumë më

e dukshme është tregtia me ndikimin që kanë bartësit e procesit. Për të tejkaluar këtë gjendje, është e domosdoshme të punësohet personel cilësor, e për këtë duhet që me saktësi të definohen kriteret e përzgjedhjes për secilën fazë të procedurës së punësimit, si dhe intensifikohet inspektimi. Në këtë drejtim është e nevojshme të forcohen kapacitetet materiale-teknike dhe njerëzore të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Për më tepër, është e nevojshme të vendosen kritere të sakta për prokurimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore në shkolla, të përcaktohen prokurimet që kryhet jashtë Ligjit për prokurime publike, si dhe kushtet dhe procedura për dhënien me qira të pronave të patundshme të institucioneve arsimore. Një segment tjetër i sektorit të arsimit ka të bëjë me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore, për të cilat është e nevojshme të sigurohet transparencë më e lartë e procesit të themelimit dhe funksionimit të organeve përkatëse kompetente. Gjithashtu, një problem tjetër në këtë sektor është se brenda institucioneve arsimore ka ende një vetëdije të ulët për trajtimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Nevojiten aktivitete të sistemuara për të rritur vetëdijësimin në këtë drejtim.

Puna dhe politika sociale. Në këtë sektor sfida kryesore është avancimi i sistemit të sigurimeve sociale, përmes krijimit të një sistemi unik dixhital dhe vendimmarrjes transparente e të drejtë në lidhje me vlerësimin e invaliditetit/aftësisë për punë, si dhe forcimi i mbikëqyrjes së procedurave për ushtrimin e të drejtave në bazë të sigurimeve sociale, pensionale dhe invalidore, dhe në bazë të ndihmës dhe kujdesit nga një person tjetër.

Urbanizmi dhe planifikimi hapësinor. Në shkurt të vitit 2020 u miratua Ligji i ri për planifikimin hapësinor dhe urbanistik, i cili mundësoi forcimin e standardeve për planifikimin hapësinor dhe urban në favor të interesit publik, analizat e detyrueshme në përgatitjen e dokumentacionit të planifikimit urban, përcaktimin e objekteve me rëndësi të veçantë për shtetin, si dhe rritjen e përfshirjes dhe transparencës së procesit të miratimit të planeve urbanistike. Duke pasur parasysh rolin thelbësor të shërbimeve të inspektimit në këtë sektor, është e domosdoshme të inicohen procedurat për heqjen e licencës për mbikëqyrje të subjektit juridik, nëse konstatohet një parregullsi në paraqitjen e gjendjes në terren.

Mjedisi jetësor. Një problem akut me të cilin përballet ky sektor është zbatimi jokonsistent i Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, në kontekst të menaxhimit të integruar dhe rajonal të mbeturinave. Prandaj, është e nevojshme që sa më shpejtë të krijohen qendra funksionale rajonale të menaxhimit të mbeturinave.

Bujqësia. Në vitet e fundit,me krijimin e politikave për mbështetje të bujqësisë, Qeveria alokon një pjesë të konsiderueshme të buxhetit për të stimuluar dhe për të rritur prodhimin bujqësor, por mbizotëron mendimi se efektet e këtyre masave nuk kanë përmbushur rezultatet e pritura, kryesisht për shkak të menaxhimit dhe zbatimit joefikas të politikave të krijuara, mbikëqyrjes së pamjaftueshme lidhur me mënyrën e përdorimit të tokës dhe mbikëqyrjes inekzistente të

përmbushjes së kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore. Për këtë shkak, është e nevojshme të ridefinohet sistemi i shitjes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore, mbikëqyrja e duhur mbi mënyrën e përdorimit të tokës dhe përmbushja e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore në pronësi shtetërore. Ndryshimet e shpeshta në rregullore, numri i madh i masave për të inkurajuar bujqësinë, kriteret e pasakta dhe ndryshimi i tyre i shpeshtë nuk çojnë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara të politikave bujqësore ose janë masa ad hoc për të kënaqur një grup specifik. Nuk ka numër të mjaftueshëm të nëpunësve të cilët do të sigurojnë ndihmë dhe këshillim për qytetarët lidhur me masat dhe procedurat për shfrytëzimin e mbështetjes shtetërore, e as mjete të mjaftueshme financiare dhe transparencë të procedurave, gjë që vonon vendimmarrjen për kërkesat jashtë afateve të parapara ligjore. Për shkak të zgjidhjeve ligjore jocilësore, ka një përqendrim i kompetencave për hartimin e politikave (akte nënligjore), bashkë me zbatimin e tyre dhe realizimin e mbikëqyrjes në fushën e ushqimit dhe mjekësisë veterinare, që të gjitha këto kërkojnë ndërhyrje urgjente ligjore.

Sporti. Ky sektor trajtohet për herë të parë nga perspektiva antikorrupsion. Si primare shtrohet nevoja për miratimin e një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore, e cila do të krijojë një koncept të qartë për këto hapësira. Është gjithashtu e nevojshme të vëzhgohet situata aktuale e objekteve sportive dhe të rishikohen kontratat për shfrytëzimin e tyre. Përveç kësaj, ka problem me inspektimet në sport, dhe për këtë duhet të vendoset një sistem inspektimi efikas i sporteve dhe objekteve sportive, si dhe të ketë edukim lidhur me integritetin dhe etikën e federatave sportive, klubeve dhe administrimin e tyre.

Ekonomia dhe biznesi. Në këtë sektor është thelbësore që sa më shpejt të përfundojë dixhitalizimi i dhënies së lejeve, vërtetimeve dhe shërbimeve të tjera të administratës publike në nivel qendror dhe lokal, gjë që do të minimizojë kontaktin midis aplikuesit dhe ofruesit të shërbimit. Një segment tjetër i rëndësishëm është jotransparenca e dhënies së ndihmave shtetërore, që parashtron nevojën për të krijuar dhe për të publikuar një regjistër me informacione për secilën formë të ndihmës shtetërore të dhënë, që do të plotësohet dhe azhurnohet në baza të rregullta. Më tutje, çështje me rëndësi të veçantë janë koncesionet për të cilat duhet të përcaktohen kritere më të hollësishme, përfshirë përgatitjen e një studimi të fizibilitetit, si dhe sigurimin e një transparence më të lartë gjatë procesit të dhënies së koncesioneve dhe mbledhjen e tarifës reale të koncesionit. Për më tepër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka regjistër të pronave shtetërore, madje nuk ka as informacione të sistemuara mbi mënyrën në të cilën menaxhohet dhe shfrytëzohet ajo pronë, gjë që bën të domosdoshëm krijimin e regjistrave të pronave të patundshme dhe të tundshme në vend. Së fundmi, procesi i politikëbërjes ekonomike duhet të përmirësohet, duke rritur transparencën e procesit të politikëbërjes dhe duke ndërgjegjësuar ndërmarrjet më të vogla për pjesëmarrjen e tyre më aktive në këto procese.

Ndërmarrjet publike. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka një bazë unike të të dhënave zyrtare për të gjitha subjektet juridike në pronësi të plotë apo të pjesërishme shtetërore dhe të NJVL-ve, që parashtron nevojën për të përgatitur një regjistër unik të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqatave aksionare në pronësi të shtetit. Është gjithashtu e nevojshme të përgatitet një program i veçantë antikorrupsion që do të synojë forcimin e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit në këto kompani. Një nga propozimet për tejkalimin e mangësive ekzistuese të kornizës ligjore është miratimi i një Ligji të veçantë për kompanitë tregtare në pronësi dominuese/ të shtetit dhe pushtetit lokal.

Mediat dhe shoqëria civile. Për të përmirësuar situatën në fushën e mediave dhe për të parandaluar abuzimin e mediave për qëllime politike, nevojitet një mbikëqyrje e zgjeruar dhe shfuqizimi i reklamimit politik të paguar të partive politike në ciklet zgjedhore. Një problem tjetër në këtë sektor është mungesa e (vetë)rregullimit të mediave në internet, e cila duhet të definohet, si dhe të bëhet azhurnimi i regjistrit të mediave profesionale. Lidhur me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), është e nevojshme të forcohet transparenca e institucioneve në planifikimin e fondeve për financimin e OSHC-ve, por edhe llogaridhënia e tyre lidhur me zbatimin dhe efektet e projekteve.

Pjesë integrale e Strategjisë është edhe një plan veprimi, ku janë shtjelluar hollësisht masat e identifikuara sipas aktiviteteve dhe indikatorëve.

Natyra komplekse e dokumentit me probleme të identifikuara nga sektorë të ndryshëm, si dhe masa të formuluara dhe aktivitete për tejkalimin e tyre, parasheh përfshirjen një morie institucionesh që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Strategjie. Duhet theksuar se për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë duhet të sigurohen burimet e nevojshme si parakusht për realizimin e qëllimeve strategjike. KSHPK-ja është organi kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Strategjisë dhe për përgatitjen e raporteve vjetore që çdo vit i dorëzohen Kuvendit deri më 31 mars.

Duke marrë parasysh që Strategjia në thelb synon përmirësimin e jetës së qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe çlirimin e shoqërisë nga korrupsionit, është e domosdoshme të sigurohet mbështetje e plotë për këtë proces, duke u dhënë përparësi aktiviteteve dhe planeve të punës së të gjitha institucioneve të parapara në këtë strategji.

Përmbajtja

HYRJE 1
1. VËSHTRIMI I VLERËSIMIT TË RREZIQEVE PËR KORRUPSION 4
2. VIZIONI DHE MISIONI I STRATEGJISË 7
3. QËLLIMET E STRATEGJISË 8
4. FUSHAT HORIZONTALE QË GJENEROJNË KORRUPSION 11
4.1. PROKURIMET PUBLIKE 11
4.2. PUNËSIMET NË SEKTORIN PUBLIK 14
5. PROBLEMET KRYESORE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT SIPAS SEKTORËVE 17
5.1. SISTEMI POLITIK 18
5.2. GJYQËSORI 22
5.3. ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT 25
5.5. ARSIMI 32
5.6. PUNA DHE POLITIKA SOCIALE 36
5.7. URBANIZMI DHE PLANIFIKIMI HAPËSINOR 38
5.8. MJEDISI JETËSOR 40
5.9. BUJQËSIA 41
5.9. SPORTI 43
5.10. EKONOMIA DHE BIZNESI 45
5.11. NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHOQËRITË AKSIONARE NË PRONËSI TË PUSHTETIT QENDROR DHE PUSHTETIT LOKAL 49
5.12. MEDIAT DHE SHOQËRIA CIVILE 51
6. BARTËSIT E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE 54
PLAN I VEPRIMIT I STRATEGJISË 56

HYRJE

Korrupsioni është një fenomen dinamik që ka shumë forma dhe ndërlidhet me faktorë të ndryshëm ekonomikë, juridikë, politikë, sociologjikë dhe faktorë tjerë. Efektet negative të korrupsionit janë të mëdha dhe me shtrirje të gjerë në sektorët publik, privat dhe të shoqërisë civile. Sjellja korruptive minon besimin në institucionet e sistemit, përdorimin efikas të resurseve publike dhe përbën një kërcënim për demokracinë dhe realizimin e të drejtave të njeriut për shkak të erozionit të vlerave shoqërore. Sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave[1], fjala korrupsion nënkupton: "abuzimin e detyrës, kompetencave publike, funksionit ose pozicionit zyrtar për përfitim personal ose për një tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes një ndërmjetësi", ndërsa me "konflikt interesi nënkuptohet një situatë në të cilën zyrtari ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e paanshme të kompetencave publike ose detyrave zyrtare të tij/saj "[2].

Integriteti dhe korrupsioni janë dy fenomene të kundërta, rrjedhimisht, çdo veprim korruptiv nënkupton shkelje të integritetit. Integriteti është cilësia e të vepruarit në përputhje me vlerat dhe normat e përgjithshme morale në dobi të interesit publik[3].

Raportet e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vlerësimet e GRECO-s, si dhe raportet e organizatave të tjera përkatëse, të gjitha këtotregojnë vazhdimisht për gjendjen e pafavorshme në trajtimin e korrupsionit. Sondazhet për perceptimet e qytetarëve tregojnë se korrupsioni pranohet si mënyrë jetese. Korrupsioni është i përhapur dhe ndodhet thellë brenda gjitha poreve të shoqërisë, që tregon nevojën për ta zvogëluar dhe për ta zhdukur atë, si një synim përfundimtar.

Lufta kundër korrupsionit kërkon përpjekje të sistemuara dhe angazhim të plotë të të gjithë pjesëmarrësve në jetën sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ka detyrim ligjor të miratojë një Strategji Nacionale pesëvjeçare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (në tekstin e mëtejmë: Strategjia), me një plan veprimi për zbatimin e saj[4]. Ky është dokumenti i parë në fushën e luftës kundër korrupsionit i cili miratohet në nivelin më të lartë, përkatësisht nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Më parë, përgatitja dhe miratimi i programit shtetëror për parandalimin dhe zbrapsjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ishin ekskluzivisht në kompetencat e KSHPK-

[1] Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 12/2019), neni 2 paragrafi (1)
[2] Po aty, neni 2 paragrafi (3)
[3] Po aty, neni 4
[4] Po aty, neni 18

së. Në periudhën 2003-2019 KSHPK-ja miratoi katër programe shtetërore[5]. Programi i fundit i referohet periudhës 2016-2019.

Miratimi i Strategjisë nga Kuvendi konfirmon seriozitetin e problemit me korrupsionin dhe nevojën për përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Politika e suksesshme antikorrupsion është pjesë edhe e procesit të integrimeve evropiane, ndërsa Strategjia është themeli për përmirësimin e kornizës ligjore dhe për ndërmarrjen e aktiviteteve reformuese.

KSHPK-ja është bartës i procesit të hartimit të Strategjisë dhe mbikëqyr zbatimin e saj, ndërsa të gjitha njësitë nga sektori publik, privat dhe civil kanë një rol aktiv në realizimin e saj. Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e të gjitha dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale antikorrupsion, duke marrë përsipër detyrime për të vepruar në këtë fushë, por në të njëjtën kohë krijon hapësirën e duhur për të fituar mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit.

Duke u nisur nga premisa që kjo Strategji është një dokument me rëndësi të jashtëzakonshme për mbarë shoqërinë, KSHPK-ja zbatoi një proces të gjerë, gjithëpërfshirës dhe transparent të përgatitjes së Strategjisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve shtetërore, institucioneve, shoqatave, fondacioneve, sektorit privat, mediave dhe përfaqësuesve të delegacionit të BE-së, OSBE-së dhe IRI-t. USAID-i ofroi ndihmë financiare dhe profesionale, veçanërisht në fushën e konceptimit metodologjik dhe menaxhimit të procesit të përgatitjes.

Në këtë drejtim, përgatitja e Strategjisë përfshiu disa hapa përgatitorë[6]:

- Hartimi i i metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve për korrupsion;
- Vlerësimi i rreziqeve për korrupsion dhe
- Zhvillimi i metodologjisë për përgatitjen e strategjisë nacionale për luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Inklusiviteti, transparenca e procesit dhe prioritetizimi u përcaktuan si parime kryesore për hartimin e Strategjisë.

Procesi i hartimit të Strategjisë filloi në gusht të vitit 2019, me krijimin e një grupi të gjerë pune, për të identifikuar dhe për të vlerësuar rreziqet për korrupsion.

Në periudhën shtator-dhjetor të vitit 2019 u mbajtën tri punëtori treditore të grupit punues, ndërsa puna praktike zhvillohej në nëngrupe, ku trajtoheshin segmente ose sektorë konkretë të sistemit shoqëror. Gjithashtu u përdorën informacionet që u ishin dhënë në dispozicion nga institucionet

[5] https://dksk.mk/index.php?id=70

[6] Këto dokumente janë të publikuara në faqen e internetit të KSHPK-së, https://dksk.mk/index.php?id=118

përkatëse, u analizuan ato, bënë vlerësimin dhe referencat e tyre krahasuese, me qëllim që t'u jepet përparësi problemeve dhe rreziqeve për korrupsion të përfshira në këtë dokument.

Gjatë hartimit të Strategjisë janë marrë parasysh këto dokumente:

- Konventa e KB-së kundër korrupsionit;
- Raportet e BE-së për progresin e RMV-së;
- Qëllimet prioritare të përcaktuara në programin nacional për adoptimin e kornizës ligjore të Bashkimit Evropian (NPAA në origjinal);
- Rekomandimet nga vlerësimet e GREKO-s;
- Sondazhet për perceptimet e qytetarëve për gjendjen lidhur me korrupsionin dhe konfliktin e interesave, si dhe analizat cilësore sektoriale;
- Programin shtetëror për parandalim dhe zbrapsjen/ e korrupsionit 2016-2019; dhe
- Strategjinë dhe dokumente të tjera relevante nacionale.

Strategjia është strukturuar si më poshtë – një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit, vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike për zbatimin e tyre, e ndjekur nga pjesa thelbësore e Strategjisë – fushat horizontale prioritare (prokurimet publike dhe punësimet) dhe problemet kryesore në 12 sektorë. Më poshtë është një kapitull për bartësit e procesit në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë.

Kjo Strategji është konceptuar ashtu që të veprojë kryesisht në mënyrë parandaluese, që nënkupton zvogëlimin e rreziqeve për korrupsion përmes ndryshimeve pozitive ligjore, forcimit të funksionalitetit të institucioneve të sistemit dhe rivendosjes së besimit në to, ngritjes së vetëdijes dhe përfshirjes së shoqërisë civile dhe opnionit publik në përpjekjet antikorrupsion. Strategjia bazohet në procese dhe qëllime reale, që duhet të rezultojnë me një ulje të vazhdueshme të korrupsionit, dhe zbatimi i saj do t'i dërgojë një mesazh të fortë shoqërisë maqedonase se lufta kundër korrupsionit më në fund po ndodh. Prandaj ky dokument duhet të jetë në agjendën e institucioneve të përfshira në zbatimin e saj.

1. VËSHTRIMI I VLERËSIMIT TË RREZIQEVE PËR KORRUPSION

Vlerësimi i rreziqeve për korrupsion ishte hapi i parë në procesin e hartimit të Strategjisë, e cila u përgatit në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të rreziqeve për korrupsion[7]. Për vlerësim u përdor një makro-këndvështrim, pra u bë një vlerësim i faktorëve të rrezikut të sistemit në tërësi. Fokusi i vlerësimit është të përcaktojë rreziqet për korrupsion lidhur me shpenzimin e parave publike ose keqpërdorimin e pozitave zyrtare në sektorin publik.

Vlerësimi i rreziqeve identifikon zonat vijuese horizontale që gjenerojnë rreziqe të mëdha korrupsioni:

- Prokurimet publike;
- Punësimet në sektorin publik;
- Inspektimet;
- Dhënia e vërtetimeve, vendimeve, licencave dhe lejeve;
- Dhënia e granteve, subvencioneve dhe ndihmave të tjera shtetërore.

Përzgjedhja e këtyre pesë fushave u bë nga grupi punues, në përputhje me pikëpamjet mbi rëndësinë e secilës fushë, fushëveprimin e saj, potencialin për korrupsion dhe ndikimin në shoqëri. Për t'u dhënë përparësi këtyre fushave, janë përdorur edhe kërkime dhe analiza të përgatitura nga disa organizata të shoqërisë civile. Përveç këtyre fushave horizontale që janë trajtuar gjatë vlerësimit, grupi punues analizoi edhe temat e mëposhtme që ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit:

- Financimi i partive politike;
- Ndikimi i palëve të interesit në procesin e përgatitjes dhe miratimit të kornizës ligjore; dhe
- Financimi i mediave dhe organizatave të shoqërisë civile.

Fusha e parë ka specifikat e veta për sa i përket potencialit dhe praktikimit të korrupsionit brenda procesit të financimit të partive politike, por rëndësia e saj është jashtëzakonisht e madhe për sa i përket pasojave nga krijimi/forcimi i një ambienti të favorshëm për korrupsion. Konkretisht, financimi i partive politike ofron një mundësi për të krijuar lidhje dhe pozicione të fuqishme, që më vonë mund të përdoren për korrupsion.

[7] https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/2019/Procenka_na_rizicite_od_korupci__a_02.10.2019_mk.pdf

Fusha e dytë është një proces përmes të cilit krijohet kornizë ligjore dhe strukturim institucional "i paqartë", përkatësisht strukturim i paqartë dhe i pasaktë i segmenteve të sistemit publik, të cilët më pas bëhen burime korrupsioni.

Financimi i mediave dhe OSHC-ve është një fushë që u shqyrtua nga KSHPK-ja dhe grupi punues në kontekst të krijimit të një mjedisi ndikimi në media dhe OSHC nga ana e partive politike dhe qeverisë. Financimi i mediave dhe organizatave të shoqërisë civile mund të jetë bazë për tregtinë me ndikim, që është shumë e rëndësishme për krijimin e opinionit publik, i cili në vend që të inkurajojë, mund të pengojë luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, në këtë kontekst, është me rëndësi që të merret parasysh ndikimi politik i theksuar.

Sa u përket sektorëve, vlerësimi u bë në tetë sektorë[8].

Gjatë vlerësimit të rreziqeve për korrupsion sipas sektorëve, fokusi ishte te sfidat sektoriale në tërësi, e jo te problemet e brendshme të institucioneve konkrete. Në këtë mënyrë, vlerësimi i rreziqeve për korrupsion u bë përmes vështrimit të problemeve në sektorin publik, ndërsa sektori privat dhe civil u analizuan në kontekst të ndërveprimit të tyre me sektorin publik, lidhur me mundësitë për korrupsion.

Bazuar në vlerësimet e rreziqeve për korrupsion sipas fushave horizontale dhe sektorëve, është bërë kombinimi i tyre me qëllim që të përcaktohet se cilat janë dhe ku gjenden rreziqet më të mëdha, me qëllim që të fillohet me krijimin e zgjidhjeve sistemike për zvogëlimin/eliminimin e tyre. Nga kombinimi i vlerësimeve të rrezikut në fushat horizontale u nxorën këto konkluzione[9]:

- Prokurimet publike dhe aspekti i inspektimit vlejnë për të gjithë sektorët dhe ndikimi i tyre në shoqëri është shumë i madh;
- Punësimet në sektorin publik janë të rëndësishme për pushtetin qendror dhe atë lokal, për shkak se edhe në këtë fushë horizontale të shoqërisë rreziku për korrupsion është shumë i madh;
- Rreziku për korrupsion në dhënien e vërtetimeve, vendimeve, licencave dhe lejeve ndërlidh sektorin publik me sektorin privat, dhe është shumë i madh si në pushtetin qendror ashtu edhe në atë lokal.

  Ekziston një rrezik i madh korrupsioni në dhënien e granteve, subvencioneve dhe ndihmave shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

  Në të gjithë sektorët e analizuar, si një emërues i përbashkët janë identifikuar këta faktorë rreziku:

[8] Po aty, gjyqësori; policia; shëndetësia publike; arsimi; transporti, urbanizmi dhe planifikimi hapësinor; ekonomia; mbrojtja e mjedisit jetësor; sporti

[9] Po aty

1. Ndikimi i fuqishëm politik në sektorin publik;
2. Probleme me sundimin e ligjit dhe niveli i ulët i sanksionimit të sjelljeve korruptive në shoqëri;
3. Korniza ligjore jokonsistente, që lë hapësirë për keqpërdorime dhe nxitjen e sjelljeve korruptive;
4. Niveli i ulët integriteti i faktorit njeri; dhe
5. Transparencë, sistem mbikëqyrjeje dhe mekanizma kontrollues të pamjaftueshëm në sektorin publik.

Bazuar në gjetjet nga vlerësimet e rreziqeve, për përgatitjen e fushëveprimit dhe përmbajtjes së Strategjisë u aprovua qasja si më poshtë:

- Nga fushat horizontale, prokurimet publike dhe punësimet në sektorin publik u nënvizuan si procese që gjenerojnë më shumë rreziqe për korrupsion, ndërsa forma e paraqitjes së tyre është e njëjtë në të gjithë sektorët e shoqërisë. Për këtë arsye, në kapitullin 4 të Strategjisë ato trajtohen në mënyrë të veçantë;
- Fushat tjera horizontale trajtohen nga prizmi i problemeve konkrete në sektorë të caktuar;
- Në Strategji janë elaboruar hollësisht këta faktorë rreziku. Ata janë reflektuar në qëllimet e Strategjisë, si dhe në problemet dhe masat prioritare në sektorë, varësisht nga specifikat e tyre;
- Sistemi politik, mediat dhe shoqëria civile trajtohen si sektorë të veçantë, në mënyrë që të shtjellojnë hollësisht ndikimin politik si një problem kryesor;
- Sektorët e ekonomisë dhe biznesit trajtohen si një shkrirje e sektorit publik dhe sektorit privat, dhe përmes kësaj ndërlidhjeje paraqitet pjesa më e madhe e fushave horizontale;
- Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë u vlerësua që duhet të trajtohen disa sektorë të tjerë (puna dhe politika sociale, ndërmarrjet publike), ndërsa policia është integruar në sektorin më të gjerë – brenda organeve të zbatimit të ligjit. Zgjerimi i përfshirjes së sektorëve është bërë për shkak të gjetjeve se të gjithë sektorët kanë probleme specifike në lidhje me korrupsionin. Prandaj, qasja e miratuar në Strategji i referohet dhënies prioritet këtyre problemeve sipas sektorëve, dhe jo rangimit dhe dhënies përparësi sektorëve me shkallë më të lartë korrupsioni. Sektorët ku janë identifikuar probleme të natyrës korruptive trajtohen në kapitullin 5.

2. VIZIONI DHE MISIONI I STRATEGJISË

Strategjia bazohet në këto angazhime afatgjata:

Vizioni:

Një shoqëri e bazuar në vlerat më të larta etike dhe të integritetit, që u mundëson gjithë qytetarëve qasje të barabartë në institucione të përgjegjshme dhe transparente, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Misioni:

Qyetarët të kenë besim në ushtrimin e pushtetit, duke fuqizuar integritetin, transparencën dhe llogaridhënien në të gjithë sektorët e shoqërisë.

3. QËLLIMET E STRATEGJISË

Zbatimi i Strategjisë Nacionale duhet të kontribuojë në uljen e nivelit të korrupsionit, avancimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjithë sektorët e shoqërisë, dhe në këtë mënyrë te qytetarët të krijojë klimë mirëbesimi të lartë lidhur me punën e pushtetit legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv. Kjo do të realizohet duke përmbushur qëllimet strategjike të mëposhtme:

1. **Rritja e nivelit të përgjegjësisë politike dhe vullnetit të demonstruar politik**

   Imperativ është që bartësit e vendimmarrjes politike t'u përmbahen standardeve më të larta të llogaridhënies dhe etikës. Partitë politike dhe udhëheqësitë e tyre duhet të tregojnë integritet të lartë, të jenë të hapura për kontroll dhe të demonstrojnë vullnet politik kundër korrupsionit. Vullneti politik duhet të konkretizohet përmes miratimit dhe zbatimit të suksesshëm të ligjeve, strategjive dhe programeve antikorrupsion.

2. **Menaxhimi i ndërgjegjshëm i ndikimit politik në sektorin publik dhe parandalimi i ndikimit politik në punën e organeve të pavarura dhe në procedurat e rregulluara me ligj**

   Strukturat politike duhet të respektojnë punën e organeve të pavarura, t'u sigurojnë atyre resurse të mjaftueshme materiale dhe financiare për të funksionuar dhe për të vepruar, të përmbahen nga çdo lloj ndikimi mbi punën e tyre dhe të mos përfshihen në procedura të rregulluara me ligj. Detyrimi kryesor i organeve të pavarura është mbrojtja e interesit publik.

   Në administratën shtetërore, si dhe në subjektet juridike ku shteti dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale ushtrojnë të drejtat pronësore, ndikimi politik duhet të menaxhohet në një mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik.

3. **Forcimi i integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik**

   Ndërtimi sistematik i një shoqërie të bazuar në integritetin individual dhe transparencën e sektorit publik paraqet qasjen më të qëndrueshme në parandalimin e sjelljes korruptive. Për këtë arsye duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të forcuar integritetin dhe llogaridhënien përmes: vendosjes së rregullave të qarta për parandalimin e konfliktit të interesave; promovimit dhe zbatimit të standardeve etike; mbrojtjes së personave që paraqesin korrupsionin; qasjes në informacione dhe transparencës lidhur me pasurinë

dhe interesat e bartësve të funksioneve publike; si dhe përdorimit të mjeteve publike në procedurat për hartimin dhe miratimin e ligjeve.

4. **Zbatimi i kompetencave në sektorin publik në mënyrë të ligjshme, transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive**

Një sektor publik profesional dhe neutral politik që vepron në mënyrë të ligjshme, transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive, në funksion të interesit publik, paraqet bazën për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e besimit të publikut në sistem.

5. **Sigurimi i integritetit dhe transparencës gjatë procesit të punësimeve dhe politikat e burimeve njerëzore në sektorin publik bazuar në një sistem vlerash dhe kriteresh të cilësisë**

Një politikë e drejtë e burimeve njerëzore, e bazuar në merita dhe e departizuar, paraqet bazën për ndërtimin e një sektori publik kompetent dhe profesional, rezistent ndaj korrupsionit. Kur bëhen punësime, është e nevojshme të ndiqen të gjitha procedurat e parapara, të zbatohen sa më shumë kritere të matshme për vlerësimin e kandidatëve në procedurën e përzgjedhjes, të zvogëlohet fuqia e së drejtës diskrete dhe të ketë procedurë plotësisht transparente.

6. **Fuqizimi i mekanizmave mbikëqyrës dhe kontrollues**

Për zbatimin e përpiktë të kornizës ligjore është e nevojshme të forcohen mekanizmat e kontrollit dhe inspektimit, të përmirësohet korniza ligjore dhe të forcohen kapacitetet njerëzore dhe materiale të organeve mbikëqyrëse, por gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme të avancohen njohuritë, aftësitë dhe integriteti i punonjësve dhe rezistenca e tyre ndaj korrupsionit.

7. **Dixhitalizimi i shërbimeve publike**

Dixhitalizimi i të gjithë sektorëve të shërbimeve publike dhe përmirësimi i vazhdueshëm i këtij procesi rrit efikasitetin dhe qasjen në ofrimin e shërbimeve publike, përshpejton proceset, zvogëlon kontaktet njerëzore dhe mundësitë për korrupsion, siguron transparencë të lartë në të gjitha nivelet, përmirëson ndërveprimin midis qytetarëve dhe qeverisë dhe proceseve të këshillimit, si dhe lehtëson kontrollet, analizën e të dhënave dhe zbulimin e korrupsionit. Zhvillimi i mëtejshëm dhe përdorimi i konceptit *Big Data*,

inteligjencës artificiale dhe teknologjisë *Blockchain* do të përmirësojnë instrumentet për parandalimin dhe zbrapsjen e korrupsionit.

8. Ulja e korrupsionit në prokurimet publike dhe në procesin e dhënies së koncesioneve, granteve, subvencioneve dhe ndihmave të tjera shtetërore

Në mënyrë që të mbrohen resurset e mëdha publike të përfshira në prokurimet publike dhe proceset e dhënies së koncesioneve, granteve, subvencioneve dhe ndihmave të tjera shtetërore, për të marrë çmimin më të mirë për shpenzimet publike, për të siguruar konkurrencë të ndershme në procedurat e prokurimit dhe për të pasur trajtim të drejtë të ofertuesve duhet që të arrihet nivel më i lartë i transparencës së proceseve, të përmirësohen zgjidhjet ligjore dhe të bëhet harmonizimi me rregulloret e BE-së, të përmirësohen sistemet moderne elektronike, të bëhen vazhdimisht përpjekje për edukimin e burimeve njerëzore dhe integritetin e tyre, si dhe të inkurajohet raportimi i parregullsive dhe të mbikëqyret procesi i përgjithshëm, përfshirë kontrollet për zbatimin e marrëveshjeve të kontratuara.

9. Forcimi i kapaciteteve dhe angazhimi i organeve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjyqësorit në zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës ndaj korrupsionit brenda radhëve të tyre

Një sistem gjyqësor konkurrues, i drejtë, efektiv dhe i paanshëm, i pavarur nga ndikimi politik është thelbësor për luftën kundër korrupsionit, si dhe për aftësinë e organeve të zbatimit të ligjit për të zbuluar, për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht krimet e korrupsionit. Mekanizmat për zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit dhe sjelljes joetike në gjyqësor dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë funksionale. Efikasiteti, pavarësia dhe integriteti i këtyre organeve janë thelbësore në ndërtimin e një perceptimi publik të suksesit të politikës antikorrupsion të vendit.

10. Mbështetje transparencës dhe integritetit në sektorin privat

Me qëllim të krijimit të një mjedis afarist konkurrues, të drejtë dhe transparent, për të tërhequr investime dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit, nevojitet mbështetje e forcimit të integritetit, transparencës, harmonizimit dhe menaxhimit të mirë korporativ në sektorin privat.

11. Ngritja e vetëdijes publike dhe realizimi i edukimit antikorrupsion

Ndërgjegjësimi i publikut për ndikimin negativ të korrupsionit, përmes fushatave antikorrupsion dhe edukimit sistemik nevojitet në të gjitha segmentet e shoqërisë .
Në luftën kundër korrupsionit një person i informuar dhe me integritet të ndërtuar është shumë i rëndësishëm.

12. Përfshirjy e shoqërisë civile dhe medias në luftën kundër korrupsionit në shoqëri dhe në ndërtimin e integritetit personal dhe profesional, edhe brenda radhëve të tyre

Është e domosdoshme të inkurajohet zhvillimi i shoqërisë civile si kontrollues i punës së autoriteteve, por edhe si partner në krijimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion. Media e lirë dhe profesionale luan një rol të rëndësishëm në zbulimin e parregullsive dhe sensibilizimin e publikut të gjerë për çështje me rëndësi shoqërore. Në mënyrë që OJQ-të dhe media të kryejnë me sukses këtë rol të rëndësishëm shoqëror dhe që mos bëhen vetë burim korrupsioni, duhet që në mënyrë sistematike të vendosen standarde të larta të integritetit, profesionalizmit dhe transparencës së tyre.

4. FUSHAT HORIZONTALE QË GJENEROJNË KORRUPSION

Vlerësimi i rreziqeve për korrupsion[10],i përpiluar si një dokument përgatitor para hartimit të Strategjisë, tregoi se ka disa fusha që shtrihen horizontalisht në të gjithë sistemin shoqëror dhe gjenerojnë një rrezik shumë të lartë korrupsioni. Prokurimet publike dhe punësimet në sektorin publik veçohen si veçanërisht të rrezikshme.

4.1. PROKURIMET PUBLIKE

Prokurimet publike paraqesin një nga fushat më të rëndësishme që realizohen në nivel qendror dhe lokal, ndërmjet institucioneve të sektorit publik, si dhe ndërmjet institucioneve të sektorit publik dhe subjekteve afariste nga sektori privat. Për kontratat e lidhura përmes prokurimeve publike në vitin 2018 janë shpenzuar mjete financiare në vlerë prej 9% të BPSH-së ose 20.6% e buxhetit qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut[11].

Në vazhdim janë dhënë problemet kryesore në sektorin e prokurimeve publike:

[10] https://dksk.mk/index.php?id=118

[11] Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2019, kapitulli 5: Prokurimet publike

1) Numri i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri të standardeve në definimin e specifikacioneve teknike, si dhe i kritereve për përcaktimin e kapacitetit të operatorëve ekonomikë;
2) Transparenca e pamjaftueshme e institucioneve dhe shkalla e ulët integritetit të personave të përfshirë në realizimin e prokurimeve publike.

Sqarimi i problemeve:

Shumë nga procedurat e prokurimeve publike me autoritetet kontratuese anulohen për shkak të mosdorëzimit të ofertave, ofertave joadekuate, fondeve të pamjaftueshme të siguruara, lëshimeve të mëdha në dokumentacionin e tenderit dhe të ngjashme. Zakonisht paraqitet vetëm një ofertë nga një operator ekonomik me të cilin autoriteti kontratues tashmë ka kontratë për të njëjtin prokurim për një periudhë më të gjatë. Të shumtën e rasteve këto probleme vijnë nga:

- definimi i gabueshëm i specifikacionit teknik ose përshtatja e tyre një operatori ekonomik të caktuar;
- definimi i pasaktë i kritereve për gjendjen ekonomike dhe financiare, si dhe i aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë;
- përcaktimi i kritereve me të cilët favorizohet operator i caktuar ekonomik; ose
- ndikimi mbi autoritetin kontratues nga persona përgjegjës.

Të gjitha këto janë rezultat i situatës së pafavorshme me kapacitetet njerëzore të autoriteteve kontratuese: numri i pamjaftueshëm i personave të përfshirë në procedurat e prokurimeve publike; ndërrimi i shpeshtë i punonjësve; përgatitja e specifikacioneve teknike nga persona pa arsimim, pa kualifikime dhe pa njohuri të duhur të lëndës së prokurimit; trajnimi i pamjaftueshëm ose joadekuat në vendosjen e duhur të kritereve të përzgjedhjes; nënshtrimi nga presionet dhe ndikimet e ndryshme etj. Këto probleme janë më të theksuara te subjektet më të vogla për shkak të numrit të kufizuar të punonjësve të cilët duhet të kryejnë prokurime të ndryshme.

Hulumtimet e organizatave joqeveritare tregojnë se institucionet (ministritë, sekretaritë, Kuvendi, komunat dhe Qyteti i Shkupit) publikojnë numër të vogël informacionesh lidhur me operacionet financiare, përfshirë prokurimet publike. Përkundër angazhimit të Qeverisë dhe detyrimeve që burojnë nga Plani i Veprimit për partneritet të hapur me Qeverinë (2018-2020), vetëm një pjesë e vogël e institucioneve në faqet e tyre të internetit publikojnë planet e prokurimeve publike; vegëzt për publikimet e SUPP të shpalljeve për prokurime publike dhe dokumentacionin e tenderit;

njoftimet për kontratën e lidhur dhe realizimin e kontratave; si dhe vetë kontratat e prokurimeve publike dhe shtojcat e tyre. Nga ana tjetër, 95% e qytetarëve të anketuar deklarojnë se nuk kanë informacione të mjaftueshme në lidhje me shpenzimin e parave publike përmes tenderëve. Si rezultat i kontrollit të pamjaftueshëm dhe pandëshkueshmërisë së autorëve, shpesh ndodh që dokumentacioni i tenderit të jetë në dispozicion të ofertuesve të caktuar, para se të publikohet në SUPP. Sipas hulumtimit të Qendrës për Komunikime Civile mbi transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në prokurimet publike për vitin 2018[12], autoritetet kontratuese përmbushin mesatarisht 55.2% të kritereve të parapara, që do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e prokurimeve publike janë në rrezik serioz korrupsioni. ***Për të kapërcyer rrethanat e këtilla duhet të forcohen kapacitetet e institucioneve me personel të kualifikuar dhe të trajnuar për kryerjen e prokurimeve publike, si dhe nevojitet rritje e integritetit institucional dhe transparencës në prokurimet publike.***

[12] https://focus.org.mk/images/2019/02/javni-nabavkiweb.pdf

4.2. PUNËSIMET NË SEKTORIN PUBLIK

Punësimet në sektorin publik lidhen drejtpërdrejt me shpenzimin e parave publike (pagat e punonjësve në sektorin publik financohen nga buxheti qendror ose buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale) dhe kanë një ndikim të madh në cilësinë dhe qasjen në shërbimet e sektorit publik, integritetin personal dhe institucional, si dhe në krijimin dhe zbatimin e politikave publike, që vetvetiu rezulton me efekte afatgjata në shoqërinë në tërësi. Punësimet në sektorin publik gjithashtu përfshijnë edhe emërimet në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse në sektorin publik, që reflektohet në cilësinë e menaxhimit të institucioneve përkatëse. Në punësimet e administratës shtetërore dhe sektorit publik ka një ndikim të fuqishëm partiak. Kjo vazhdimisht është cekur edhe në raportet vjetore të Komisionit Evropian për progresin e vendit. Në shumë raste përdoren procedurat për punë të përkohshme ose kontratat mbi vepër me kritere më të ulëta, duke anashkaluar kështu Ligjin për nëpunës administrativë.

Legjislacioni lejon punësimin afatgjatë të personave në sektorin publik përmes kontratave në vepër, agjencive të të drejtave autoriale ose agjencive për punësime të përkohshme, të cilat nxisin ndikimin partiak në punësime në mënyrë plotësuese, praktikimin e nepotizmit dhe formave tjera të sjelljes korruptive. Procedurat për punësim në sektorin publik nuk janë plotësisht transparente. Transparente nuk janë as kriteret që kanë qenë thelbësore për përzgjedhjen. Këto procedura nuk japin mundësinë që palët e interesuara të kenë qasje në zhvillimin e gjithë procesit të rekrutimit. Të gjitha këto gjenerojnë një rrezik shumë të madh për korrupsion në punësimet e sektorit publik.

Në vazhdim janë problemet kryesore të punësimeve në sektorin publik:
1) Mosharmonizimi i një numri të madh të ligjeve që rregullojnë sferën e punësimeve, që lejon çfarëdo lloj ndikimi: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm; 2) Menaxhimi, administrimi dhe mbikëqyrja joefikase e organeve të caktuara të administratës, agjencive, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore; 3) Legjislacioni nuk ka paraparë një sistem të qartë për vlerësimin e kritereve të përzgjedhjes në procesin e punësimit në sektorin publik.

<u>Sqarimi i problemeve:</u>

Ekzistojnë një numër i caktuar ligjesh që rregullojnë punësimin sipas sektorëve, fushave dhe institucioneve që ndryshohen shpesh, nuk janë të harmonizuara dhe nuk sigurojnë barazi në procesin e punësimit. Aktet e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës po ashtu u nënshtrohen ndryshimeve të shpeshta lidhur me kriteret për arsimin e duhur dhe numrin e personave që do ta ushtrojnë pozitën e shpallur, pa u bazuar në analiza funksionale dhe pa arsyetim real se arsimi që kërkohet është adekuat për atë vend pune. Organet e administratës shtetërore, NP-të dhe NJVL-të, nuk kanë një praktikë publikimi të akteve për sistematizim në faqet e tyre të internetit. Në disa prej tyre këto akte kanë shkallë klasifikimi me qëllim që punësimet të bëhen pa shpallje të një konkursi publik. E gjithë kjo ndikon në transparencën e procesit të punësimeve dhe lejon keqpërdorimin e së drejtës diskrete të atyre që janë përgjegjës për këto procese.

Për të kapërcyer këtë situatë është e nevojshme të ndërmerren masat e mëposhtme:

- ***Heqja e mundësisë për punësim të përkohshëm përmes agjencive të punësimit të përkohshëm;***
- ***Heqja e mundësisë që punësimet e përkohshme të fitojnë statusin e kontratave të punës me afat të pacaktuar, pa procedurë të rregullt punësimi;***
- ***Vlerësimi i nevojave reale për numrin e të punësuarve dhe për ekspertizën e tyre në organet e sektorit publik;***
- ***Përkufizimi i qartë i nivelit arsimor për një vend të caktuar pune në aktet për sistematizimin e pozitave;***
- ***Rritja e transparencës së procesit të punësimeve në sektorin publik.***

Ligjet materiale që rregullojnë themelimin, funksionimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e organeve të caktuara administrative, agjencive, shoqërive aksionare, ndërmarrjeve publike etj., **nuk përmbajnë kritere për arsimimin e duhur të menaxherëve, e as masa, kritere dhe kompetenca bazike minimale lidhur me zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse.** Aktet për sistematizimin e vendeve të punës në ndërmarrjet publike të krijuara nga Qeveria e RMV-së dhe NJVL-të ose ndërmarrjet aksionare në pronësi të shtetit nuk përfshijnë pozicionet drejtuese, e nëse ato janë të përfshira, nuk përcaktohet niveli i arsimit të kërkuar. Zgjedhja e anëtarëve të bordeve mbikëqyrëse dhe drejtuese bëhet nga themeluesi (Qeveria ose këshilli i NJVL-ve), i cili zgjedh drejtorin dhe/ose zëvendësdrejtorin. Bordet mbikëqyrëse dhe drejtuese zakonisht nuk funksionojnë për shkak se themeluesi nuk emëron në kohë numrin e kërkuar të anëtarëve ose për shkak se funksionin e drejtorit e kryen ushtruesi i detyrës së drejtorit për disa herë me radhë.

Këto rrethana çojnë në udhëheqje, funksionim dhe mbikëqyrje joprofesionale të këtyre subjekteve; nënçmojnë integritetin e personave të emëruar dhe vënë në dyshim vendimet e marra nga organet drejtuese. **Për të kapërcyer rrethanat e këtilla negative është e nevojshme që:**

- ***Të optimizohet numri i anëtarëve në bordet mbikëqyrëse dhe drejtuese në organet e administratës, NP-të dhe shoqëritë aksionare; dhe***
- ***Të vendosen kritere për nivelin e arsimit dhe kompetencave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe emërimin e anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse.***

Korniza ligjore për punësim **nuk përcakton një mënyrë të qartë e transparente për vlerësimin e kritereve të përzgjedhjes për punësim, që do të ishte e zbatueshme për sektorin publik në tërësi**. Procedurat për punësim në shëndetësi, arsim, kulturë dhe mbrojtje sociale rregullohen me ligje të veçanta materiale, të cilat nuk parashikojnë një mënyrë objektive dhe transparente të përzgjedhjes së kandidatëve dhe vlerësimit me pikë në faza të ndryshme të përzgjedhjes, siç parashihet me dekretin për zbatimin e procedurës së punësimit të nëpunësve administrativë[13]. Për shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, të cilat bëjnë punësime në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune, i cili nuk parasheh asnjë kriter, Qeveria si themelues nuk ka vendosur kritere për një mënyrë të qartë dhe transparente të vlerësimit të kritereve të përzgjedhjes për punësim. Në rrethana të tilla, vendimet për punësim shpesh bazohen në subjektivitetin e personit përgjegjës, i/e cili/cila, duke përdorur të drejtën diskrete, mundëson punësimin e anëtarëve të partisë ose personave të afërt. **Prandaj është e nevojshme të zbatohen masat e mëposhtme:**

- ***Të vendoset një proces i qartë dhe transparent i vlerësimit të kritereve për punësim në shëndetësi, arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe shoqëri aksionare në pronësi të shtetit; dhe***
- ***Të kufizohet e drejta diskrete e personit përgjegjës gjatë procesit të punësimit.***

[13] Gazeta Zyrtare, nr. 27/2018

5. PROBLEMET KRYESORE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT SIPAS SEKTORËVE

Vlerësimi i rreziqeve për korrupsion[14] i paraqitur në kapitullin 2 të këtij dokumenti, tregoi qartë se rreziqet e korrupsionit ekzistojnë në sektorin publik, privat dhe atë të shoqërisë civile.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e tre sektorëve, veçanërisht sektorin publik i cili përfshin një numër nënsektorësh, e në mënyrë që të sigurojë identifikimin e problemeve kryesore që gjenerojnë rrezikun e korrupsionit, duhet të bëhet prioritetizimi i problemeve bazuar në kriteret që lidhen me intensitetin e problemit, të shihet ndikimi brenda sektorit dhe në një rreth më të gjerë shoqëror, si dhe cili do të jetë efekti i zgjidhjes/zbutjes së problemit në uljen e nivelit të korrupsionit në vend.

Në Stretegji janë të përfshira këta sektorë:

1) Sistemi politik;
2) Gjyqësori;
3) Orgaget e zbatimit të ligjit;
4) Shëndetësia;
5) Arsimi;
6) Puna dhe politika sociale;
7) Urbanizmi dhe planifikimi hapësinor;
8) Mjedisi jetësor;
9) Bujqësia;
10) Sporti
11) Ekonomia dhe biznesi;
12) Ndërmarrjet publike dhe
13) Mediat dhe shoqëria civile.

Në vazhdim janë trajtuar problemet kryesore konkrete për secilin nga sektorët e sipërpërmendur.

[14] https://dksk.mk/index.php?id=118

5.1. SISTEMI POLITIK

Nga perspektiva e kësaj strategjie nacionale, sektori i sistemit politik përfshin pushtetin dhe politikën, me një fokus të veçantë në pushtetin ligjvënës, ku përfshihen proceset e vendimmarrjes në nivel politik, si ligje, politika, strategji dhe lloje të tjera aktesh të përgjithshme, në të gjitha fazat, nga fillimi kur fillon përpilimi i tyre, deri në marrjen e vendimeve.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një demokraci parlamentare, kështu që mënyra në të cilën funksionon Kuvendi është thelbësore për zhvillimin e proceseve demokratike në vend dhe kushtëzon fuqimisht përmbushjen e politikave të planifikuara antikorrupsion. Kjo nënkupton vendosjen dhe respektimin e vazhdueshëm të parimeve të ndërgjegjshmërisë, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e Kuvendit. Për nga definimi dhe funksioni që ka, procesi zgjedhor, është një pjesë integrale e sistemit politik të vendit dhe si i tillë duhet të mundësojë konkurrencë të shëndoshë të subjekteve politike dhe të parandalojë çdo abuzim potencial për përfitime të palejueshme të një pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore. Por, nga këndvështrimi i rrezikut për korrupsion, përmendet në pothuajse të gjitha fushat e trajtuara në këtë strategji. Qëllimi i ndryshimeve në procesin e vendimmarrjes është të zvogëlojë ose të eliminojë praktikën e vendimmarrjes pa analiza, pa konsultime dhe me ndikim nga interesi privat. Përveç Kuvendit të RMV-së, institucionet dhe organet kryesore kompetente në sektorin e sistemit politik janë Qeveria e RMV-së, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), KSHPK-ja dhe Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR).

Në vazhdim janë problemet kryesore që duhet të trajtohen në sektorin e sistemit politik:

1. Miratimi i një numri të madh ligjesh me procedurë të shkurtuar, pa sqarim adekuat për arsyeshmërinë për këtë lloj procedure;
2. Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullores pa analiza përkatëse të cilësisë, pa vlerësim të ndikimeve dhe pa procese konsultative për mbrojtjen e interesit publik;
3. Mossanksionimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë;
4. Ndërveprimi i padefinuar i lobistëve dhe përfaqësuesve të organeve ligjvënëse dhe ekzekutive, si dhe i zyrtarëve të pushtetit lokal;
5. Përfshirja e pamjaftueshme e zyrtarëve të nivelit të lartë në programet edukative në fushën e etikës dhe integritetit;

6. Moskezistimi i asnjë mekanizmi ose organi për monitorimin efektiv të përfaqësimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit.

Sqarimi i problemeve:

Problemi kryesor në promovimin e integritetit të sistemit politik është mënyra e rregullimit të proceseve të vendimmarrjes. Bëhet fjalë për një parim të përgjithshëm, të zbatueshëm në të gjitha nivelet, si në pushtetin ekzekutiv ashtu edhe në atë legjislativ, që duhet të dekurajojë ose të minimizojë ndërhyrjen e interesit privat ose interesave të grupeve të caktuara të palëve të përfshira.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut procesi i vendimmarrjes ndikohet nga intervencat dhe interesat që ofrojnë përfitime për palët e interesit. Rregullimi ligjor dhe nënligjor i fushave të caktuara, vendimet për subvencione, ndihmë, mbledhje dhe blerje të prodhimeve nga shteti etj., rrallë përmbajnë një analizë të hollësishme të arsyeshmërisë dhe evidencë transparente të procesit konsultativ me palët e interesit. Rreziku që ato të përdoren për të kënaqur interesat afariste ose besnikërinë e votuesve rritet kur nuk respektohen rregullat e vendimmarrjes.

Në Rregulloren e punës të Kuvendit nuk ka kritere për përcaktimin e kompleksitetit dhe vëllimit të ligjeve, siç është rasti me ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, dhe kjo i jep hapësirë propozuesit të përdorë procedurën e shkurtuar për miratimin e ligjeve pa sqarime të mjaftueshme. Kjo nënkupton që kjo procedurë përdoret padrejtësisht për të kënaqur interesat e ngushta partiake ose të grupeve, e ***për këtë shkak duhet të ndryshohet Rregullorja e punës e Kuvendit të RMV-së, duke përcaktuar kriteret për kompleksitetin dhe vëllimin e projektligjeve.***

Sigurimi i një procesi vendimmarrës të bazuar në integritet është rezultat i një numri rregullash të përfshira në Rregulloren e punës të Qeverisë, Kuvendit dhe komunave, si dhe kodeve etike për zyrtarët. Mirëpo, procesi i vlerësimit të ndikimit ligjor (procesi VNL), që duhet të përdoret për çdo ligj të ri ose ndryshim të legjislacionit ekzistues të propozuar nga Qeveria, nuk zbatohet në praktikë. Në të njëjtën kohë, pavarësisht nga fakti se sipas Rregullores së unës të Qeverisë, ministritë janë të detyruara të kërkojnë mendim nga KSHPK-ja në lidhje me projektligjet që i nënshtrohen procesit VNL, në vitin 2018 KSHPK-së iu dorëzua vetëm një ligj për shqyrtim antikorrupsion[15]. Prandaj, është e nevojshme që të respektohen vazhdimisht parimet e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e VNL-së: një analizë më cilësore e shpenzimeve dhe

[15] Të dhënat janë marrë nga KSHPK-ja

efekteve nga vendimi i propozuar, në mënyrë që çdo ndryshim i politikave të shpjegohet me prova dhe sqarime. Për më tepër, është e nevojshme të mbahet evidencë e saktë e procesit të konsultimit, që do të sigurojë një pasqyrë se kush janë ata që ndikuan në marrjen e një vendimi të caktuar. Për shkak se fokusi i kësaj pjese është në procesin e vendimmarrjes, thelbi i problemit është se si të zvogëlohen efektet e dëmshme të lobimit. Prandaj është me rëndësi që të forcohet integriteti gjatë procesit të hartimit të VNL-së, si një proces që siguron vendimmarrje të bazuar në analiza, si dhe për të identifikuar më tej interesa të veçantë në kornizën ligjore përmes APL. ***E gjithë kjo tregon nevojën për të rregulluar procesin VNL, përmes miratimit të një metodologjie të re***.

Praktika aktuale tregon se **persona të caktuar të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratë pasurie** ose deklaratë interesi, nuk kanë përmbushur detyrimin e paraparë edhe pas shqiptimit të sanksionit kundërvajtës. Për shkak të kësaj, është e nevojshme të vendoset një mekanizëm shtesë për sanksionimin e këtyre rasteve, përkatësisht ***të definohet "refuzimi i raportimit të pasurisë dhe interesave" nga personat që kanë një detyrim të tillë ligjor dhe të definohen masat për përcaktimin e përgjegjësisë së këtyre personave.***

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekziston një ligj për lobimin, por në praktikë ai është jofunksional. Akoma nuk janë përcaktuar rregullat për mënyrën e zhvillimit të procesit të lobimit, veçanërisht në fushën e ndërveprimit midis lobistit, zyrtarit dhe palëve të treta që kanë interes për vendime të caktuara. Në mungesë të këtyre rregullave, lobimi vazhdon të zhvillohet në forma të ndryshme alternative, të cilat shpesh bazohen në veprime joparimore dhe madje edhe korruptive. ***Prandaj është e nevojshme që të miratohet urgjentisht një ligj i ri për lobimin.***

Në një situatë ku është e pamundur që të rregullohet plotësisht çdo detal i funksionimit të sistemit**, përmbushja e kompetencave nga zyrtarët duhet të bazohet në parimet e etikës, ndërgjegjes, përgjegjësisë dhe paanësisë**, si dhe të të gjithë elementëve të tjerë që përbëjnë integritetin e një bartësi të funksionit publik. Kjo vlen veçanërisht për bartësit e funksioneve më të larta publike në pushtetin ekzekutiv, të cilët vendosin për çështje madhore, që nga ana tjetër nënkupton posedimin e standardeve më të larta të integritetit. Duke pasur parasysh këtë, ***nevojitet fuqizimi i sistemit për forcimin e integritetit të bartësve më të lartë të pushtetit ekzekutiv, përmes krijimit të një programi të përshtatshëm dhe trajnimeve.***

Nuk ekziston asnjë mekanizëm ose organ për monitorimin efektiv të përfaqësimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore në portalet e internetit. Megjithëse Kodi Zgjedhor parasheh që ASHMAA-ja duhet të monitorojë reklamimin përmes këtyre portaleve, në praktikë kjo nuk realizohet për faktin se nuk ka kornizë ligjore për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e funksionimit të tyre. Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e reklamave politike gjatë procesit zgjedhor

realizohen përmes portaleve të internetit, për ç'gjë ata marrin fonde të konsiderueshme nga Buxheti i RMV-së. Këto pagesa bëhen përmes KSHZ-së, përkundër faktit që KSHZ-ja nuk është në gjendje të kontrollojë dhe të konfirmojë bazën e këtyre pagesave të realizuara. Për të zvogëluar rreziqet e ndikimit dhe keqpërdorimit të mjeteve buxhetore, ***duhet që pagesa për reklamim në këto media interneti të mos jetë barrë e Buxhetit të RMV-së.***

5.2. GJYQËSORI

Gjyqësori është një sektor kyç për sundimin e ligjit. Në kontekst të kësaj Strategjie, ky sektor përfshin të gjitha institucionet me kompetencë për të procesuar lëndë dhe që vendosin për to: prokurorët, Avokatura e Shtetit, gjykatat dhe organet tjera përkatëse – Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë, Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Sipas Kushtetutës dhe ligjit, Gjyqësori është organ i pavarur. Ministria kompetente që propozon ligjet në këtë fushë është Ministria e Drejtësisë, e cila ka kompetencë edhe në organizimin dhe mbikëqyrjen e administratës gjyqësore.

Në vazhdim janë problemet kryesore të sektorit gjyqësor:

1) Sistemi pa efikasitet të mjaftueshëm për forcimin e integritetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike;
2) Kapacitetet e pamjaftueshme materiale dhe njerëzore, mungesa e një sistemi të automatizuar për delegimin dhe monitorimin e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme e punës së Këshillit të Prokurorëve Publikë;
3) Efikasiteti dhe transparenca e pamjaftueshme e punës së Avokaturës së Shtetit.

Sqarimi i problemeve:

Ekziston një sistem pa efektivitet të mjaftueshëm për forcimin e integritetit të faktorit njeri në gjyqësor dhe prokurorinë publike. Me miratimin e Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor dhe ndryshimet në Ligjin për gjykatat, është krijuar një bazë solide për monitorimin e punës së gjykatësve dhe aspektin e përgjegjësisë së tyre. Megjithatë, ka mungesë të një sistemi efektiv për forcimin e integritetit të faktorit njeri në gjyqësor, përmes afirmimit dhe zbatimit të kodeve të sjelljes profesionale. Këto kode sjelljeje në përgjithësi vendosin një kornizë të kënaqshme për standardet e sjelljes profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, por nuk shoqërohen me shembuj dhe komente adekuate që do të lehtësonin zbatimin e tyre. Nga ana tjetër, Ligji për Prokurorinë Publike nuk përmban dispozita që rregullojnë mënyrën e miratimit të Kodit të Etikës, që shkakton dilema në përgatitjen dhe miratimin e tij. ***Prandaj duhet që kodet e sjelljes profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publikë të plotësohen me komente dhe shembuj, si dhe të plotësohet Ligji për Prokurorinë Publike me dispozita që përcaktojnë Kodin e Prokurorëve Publikë dhe mënyrën e miratimit të tij.***

Praktika e deritanishme tregon se pothuajse nuk ka interes nga gjykatësit dhe prokurorët publikë për të marrë pjesë në trajnime në lidhje me forcimin e integritetit dhe njohjen me kodet e sjelljes

profesionale dhe zbatimin e tyre praktik. Një situatë e tillë është e papranueshme, sidomos duke pasur parasysh faktin se ushtrimi i paanshëm dhe i përpiktë i funksionit gjyqësor dhe prokurorisë publike është thelbësor për këtë sektor. Në kushtet kur ka një sjellje të papërshtatshme të gjykatësve dhe prokurorëve publikë në kryerjen e detyrave të tyre ose jashtë vendeve të tyre të punës, vetvetiu imponohet konkludimi se ata nuk zbatojnë standardet e kodeve të sjelljes profesionale. ***Për të tejkaluar këtë situatë, duhet të organizohen trajnime të detyrueshme për gjykatësit dhe prokurorët publikë me qëllim të zbatimit të kodeve të sjelljes profesionale.***

Megjithëse Ligji për procedurë penale u miratua në vitin 2014, Prokuroria Publike përballet ender me probleme të mëdha në kryerjen e funksionit të saj. ***Kompetenca e shtuar e prokurorisë në pjesën e kryerjes së procedurës hetimore nuk u shoqërua me logjistikë adekuate materiale-teknike dhe kapacitete kuadri. Qendrat hetimore të parapara me LPP-në nuk janë krijuar akoma, e në këtë mënyrë Prokuroria Publike vazhdon të jetë shumë e varur nga mbështetja e Ministrisë së Punëve të Brendshme***. Lëndët në Prokurorinë Publike shpërndahen në mënyrë manuale, gjë që vë në rrezik delegimin joparimor të lëndëve te prokurorë të caktuar. Nuk ka një sistem elektronik efikas për ndjekjen e rasteve në varësi të fazës së procedurës në të cilën ato ndodhen. ***Është e nevojshme të rriten kapacitetet dhe resurset e sistemit të Prokurorisë Publike, të bëhet ekipimi i prokurorive publike me kuadër të duhur, në përputhje me sistematizimin ekzistues të vendeve të punës, të krijohen qendra hetimore, si dhe të vendoset një sistem i automatizuar për delegimin dhe monitorimin e lëndëve në Prokurorinë Publike***.

Problem gjithashtu paraqet edhe efikasiteti dhe transparenca e pamjaftueshme e punës së Avokaturës së Shtetit (ASH) për shkak të dobësive në ligjin përkatës:

- varësia e Avokaturës së Shtetit nga Qeveria në lidhje me përcaktimin e numrit të avokatëve shtetërorë, selinë dhe fushëveprimin;
- mosekzistimi i një sistemi vlerësimi për avokatët shtetërorë si mënyrë për të verifikuar efektivitetin dhe efikasitetin e tyre;
- mënyra jo e rregullt e shkarkimit të avokatëve shtetërorë; inicimi i paparashikuar i procedurave disiplinore kundër një avokati shtetëror;
- afate të papërcaktuara për dorëzimin e raportit vjetor mbi punën e Avokaturës së Shtetit në Qeveri, e as detyrime për Qeverinë që të shqyrtojë dhe të miratojë një raport vjetor;
- delegimi manual i lëndëve për shkak të mungesës së rrjetit kompjuterik adekuat,

janë pjesë e problemeve që këtë sektor të sistemit të drejtësisë e bëjnë joefikas dhe jotransparent. Ky organ ka kompetenca që të kujdeset për interesat e RMV-së në lidhje me shfrytëzimin e pronës

shtetërore dhe vepron si përfaqësues i saj në procedurat gjyqësore. Në këtë drejtim, ASH-ja jep mendime dhe pëlqime për tjetërsimin e tokës dhe pasurive të tjera të patundshme në pronësi të shtetit. Duke qenë se kjo është një kompetencë shumë e rëndësishme e ASH-së e cila prek interesin publik, ***nevojitet miratimi i një zgjidhjeje të re ligjore që do të mundësojë tejkalimin e problemeve të sipërpërmendura në funksionimin e Avokaturës së Shtetit***.

Situata aktuale në gjyqësor tregon se përveç rreziqeve të detektuara për korrupsion, e për të cilat kjo strategji propozon masat e duhura, ***ekzistojnë edhe fusha dhe faktorë të tjerë rreziku që pengojnë funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë***. Në një situatë kur gjyqësori po mbytet nga joefikasiteti, në kohën kur kanë filluar procedura penale kundër personave nga niveli më i lartë i hierarkisë gjyqësore dhe prokurorisë dhe kur besimi i publikut në gjyqësor është jashtëzakonisht i ulët, duhet të merren parasysh masa më radikale për t'u rikuperuar nga situata aktuale. Karakteri i masave dhe lloji i veprimeve që duhen zbatuar, duhet të planifikohen me kujdes, duke pasur parasysh që të mos shkaktohet bllokim i funksionimit të sistemit të drejtësisë. ***Për atë qëllim është e nevojshme të bëhet një analizë e thellë dhe një vlerësim shtesë i rreziqeve për korrupsion në gjyqësor***.

5.3. ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Disa nga organet e zbatimit të ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut Disa janë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Drejtoria e Policisë Financiare (DPF), Drejtoria e Inteligjencës Financiare (DIF) dhe Drejtoria e Doganave (DD). Gjithashtu, një rol shumë të rëndësishëm në sistemin për zbatimin e duhur të ligjeve dhe për zbulimin e parregullsive kanë organet mbikëqyrëse, përkatësisht shërbimet e inspektimit në nivel qendror dhe lokal, si dhe sistemi i auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Për nga natyra e kompetencave të tyre, organet e lartpërmendura shpesh janë të ekspozuara ndaj presioneve dhe ndikimeve korruptive, të cilat në fund dosido çojnë në humbjen e besimit të qytetarëve në funksionimin e sistemit në tërësi. Prandaj është e nevojshme që këtyre organeve t'u kushtohet vëmendje e madhe në drejtim të përmirësimit të kornizës së tyre ligjore dhe përforcimit të kapaciteteve të tyre financiare, materiale dhe njerëzore, si dhe të integritetit të punonjësve të tyre.

Raporti i Vlerësimit GRECO për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 (raundi i pestë i vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksionet më të larta ekzekutive[16]) dhe institucionet e zbatimit të ligjit) përmban shumë vërejtje në lidhje me mundësitë e sjelljes korruptive në këto institucione; janë dhënë katërmbëdhjetë rekomandime për përmirësimin e situatës në këtë fushë, të cilat RMV-ja është e detyruar t'i zbatojë.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e organeve të zbatimit të ligjit:

1) Kompetencat e mëdha me të drejtë diskrete të personave përgjegjës dhe jotransparencë në punësim dhe ngritje në detyrë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
2) Sistemi joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet e zbatimit të ligjit;
3) Mënyra e paqartë dhe e pasaktë e përcaktimit të kompetencave dhe dyfishimi i kompetencave të inspektorateve;
4) Veprimi subjektiv dhe joadekuat i inspektorëve në ushtrimin e kompetencës së tyre;
5) Inspektimi i pamjaftueshëm funksional në vetëqeverisjen lokale;
6) Moszbatimi i rekomandimeve të revizionit të brendshëm dhe ESHR-së nga ana e drejtuesve të institucioneve;

[16] https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/168095378c

7) Ndikimi i personave përgjegjës në institucionet publike mbi pavarësinë e revizionit të brendshëm.

Sqarimi i problemeve:

Ligji për punët e brendshme nuk siguron transparencë të mjaftueshme të procedurave për punësim dhe ngritje në detyrë në MPB, e ndërkohë lejon përdorimin maksimal të së drejtës diskrete. Jotransparenca është rezultat i faktit që ligji lejon punësim pa shpallur konkurs publik për pozicionet e parapara me status *"zyrtarë të autorizuar"*, si dhe për shkak të faktit se aktet për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë dokumente konfidenciale me shkallë të caktuar klasifikimi. Kjo krijon kushte për nepotizëm, kronizëm, punësimin e personave joprofesionistë dhe të paverifikuar në radhët e policisë dhe Ministrisë, si dhe partizimin e sistemit që duhet të mbrojë dhe të sigurojë popullatën. ***Përmirësimi do të arrihet me transparencën e akteve për sistematizimin e procesit t***ë ***punësimit dhe avancimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.***

Sistemi joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet e zbatimit të ligjit. Personat e autorizuar të punësuar në DPF dhe DIF kanë kompetenca të mëdha në veprimet e tyre në raport me subjektet tjera, dhe, në rast të shkeljes së detyrës, u nënshtrohen procedurave disiplinore në bazë të Ligjit për nëpunës administrativë, përmes komisioneve disiplinore të formuara ad hoc, sepse në këto institucione nuk ka asnjë sistem për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale. Përcaktimi i përgjegjësisë profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtorinë e Doganave bëhet përmes komisioneve disiplinore të formuara nga Ministri, përkatësisht nga drejtori i Drejtorisë së Doganave dhe nga radhët e punonjësve në njësitë organizative ku është sistematizuar punonjësi kundër të cilit zhvillohet procedura përkatëse, dhe kjo krijon një rrezik solidariteti, shtyerjeje të procedimit ose mosshqiptimi të një mase adekuate. ***Për zbulimin dhe sanksionimin e suksesshëm të parregullsive nevojitet forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm në DPF dhe DIF, e po ashtu duhet të krijohen komisione disiplinore qendrore në MPB dhe në Drejtorinë e Doganave.***

Disa nga ligjet materiale që i referohen fushëveprimit dhe funksionimit të inspektorateve të caktuara, përmbajnë ***kompetenca të pamjaftueshme ose të paqarta***, gjë që lë hapësirë për veprime jo të plota dhe joefikase të disa inspektorateve. Në praktikë, kjo çon në situata përplasjeje apo dyfishimi të kompetencave të caktuara të inspektorateve, si dhe zbrazëtira në rregullimin e inspektimeve mbikëqyrëse në fusha të caktuara. ***Që të përcaktohen kompetencat e shërbimeve të inspektimit në mënyrë të saktë, duhet të përmirësohet korniza ligjore.***

Veprimi subjektiv dhe joadekuat i inspektorëve në ushtrimin e kompetencave të tyre. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, inspektorët veprojnë në mënyrë të pavarur, kurse vendimet për gjendjen e vërtetuar faktike, masat dhe ndëshkimet në raste të shkeljeve ligjore bëhen në mënyrë të pavarur. Për shkak të kompetencave dhe pushtetit që ata kanë në shqiptimin e gjobave të larta, pavarësia e veprimit mund të përdoret për interesa personale ose të keqpërdoret. ***Është e nevojshme të analizohen rreziqet sistemike për korrupsion në shërbimet e inspektimit dhe mënyrat për t'i eliminuar ato, duke forcuar integritetin e inspektorëve, përfshirë detyrimin për të dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe konfliktin e interesave.***

Me procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në njësitë e vetëqeverisjes lokale u vendos kategoria *"inspektorë komunalë të autorizuar"*, të cilët kanë statusin e punonjësve administrativë. Mirëpo, ***nuk ka harmonizim të kompetencave të inspektorëve shtetërorë dhe komunalë***. Shumë komuna kanë një shërbim të vogël administrativ, e për këtë arsye inspektimin mbikëqyrës e bëjnë persona me kompetenca të dhëna nga kryetarët e komunave, të cilët nuk kanë kualifikimet dhe njohuritë e duhura. Ligji për ndërtim, ligjet në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale nuk sigurojnë pavarësi të inspektorëve të autorizuar, dhe në veprimet e tyre dhe miratimin e akteve ka një ndikim të fuqishëm si nga kryetarët e komunave, ashtu edhe nga palët tjera të interesit. Për të përmirësuar sistemin e inspektimit në nivelin lokal, ***duhet të forcohet integriteti i shërbimeve të inspektimit dhe rritja e kapaciteteve njerëzore me staf profesional***.

Revizioni i brendshëm dhe i jashtëm drejtuesve u paraqet raporte për funksionimin e institucionit, me gjetje dhe rekomandime për ndryshimin dhe avancimin e punës së këtij institucioni. ***Udhëheqësia e institucioneve shpesh nuk zbaton rekomandimet nga revizioni i brendshëm dhe ESHR-ja***, sepse zgjidhjet ligjore nuk parashikojnë përgjegjësi në rast të mosveprimit në lidhje me rekomandimet nga raportet e revizionit. Kjo ndikon në funksionimin e institucionit, integritetin e punonjësve dhe rrezikon funksionimin ekonomik dhe efektiv të vetë institucionit. ***Është e domosdoshme të vendoset një sistem efikas për zbatimin e rekomandimeve, por edhe një sistem i përgjegjësisë.***

Në përputhje me Ligjin për revizionin e brendshëm financiar në sektorin publik, revizioni i brendshëm formohet në të gjitha entitetet e sektorit publik ku buxheti mesatar vjetor/plani financiar në tre vjetët e fundit tejkalon shumën 50 milionë denarë. Nëse nuk formohet njësi e tillë, revizioni i brendshëm organizohet me angazhimin e një revizori nga një entitet tjetër i sektorit publik ose revizor/ë nga regjistri i revizorëve të brendshëm të udhëhequr nga njësia qendrore e harmonizimit pranë Ministrisë së Financave. Pavarësia organizative e revizionit të brendshëm nuk parandalon rrezikun e ndikimit të personave përgjegjës mbi sjelljen e pavarur të revizorëve, profesionalizmin në kryerjen e revizionit, objektivitetin e gjetjeve të paraqitura, si dhe zbatimin e përpiktë të rekomandimeve të dhëna. *Për shkak të kësaj,* ***është e nevojshme që të sigurohet pavarësi më e***

madhe dhe më objektive e punës së revizionit të brendshëm, për të përmirësuar kornizën institucionale në mënyrë që puna e revizionit të brendshëm në sektorin publik të organizohet përmes një njësie të re organizative në Ministrinë e Financave.

5.4. SHËNDETËSIA

Në kontekst të kësaj strategjie, sektori i shëndetësisë përbëhet nga institucione publike me kompetencë për çështje në fushën e kujdesit shëndetësor, institucione shëndetësore publike dhe private, si dhe nga kompani të mëdha farmaceutike. Këtu fillimisht përkasin Ministria e Shëndetësisë dhe organet e saj të pavarura, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), si dhe njësitë operacionale: qendrat klinike, poliklinikat dhe institucionet e tjera që veprojnë në fushën e shëndetit publik. Korrupsioni në shëndetin publik trajtohet shumë pak në raportet përkatëse të korrupsionit, por përmes sondazheve të ndryshme qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre për nivelin e lartë të korrupsionit në shëndetësi. Ministria e Shëndetësisë nuk bën vlerësimin e rreziqeve për korrupsion dhe as nuk përmendet në ndonjë nga dokumentet strategjike në këtë sektor.

Rreziqet për korrupsion në shëndetësi ndërlidhen kryesisht me kryerjen e veprimtarisë themelore – sigurimin e shërbimeve shëndetësore, punësimet dhe posaçërisht me procedurat e prokurimeve publike, duke pasur parasysh që në këtë sektor realizohen vazhdimisht një numër i madh prokurimesh me vlerë të lartë (të pajisjeve mjekësore, barnave dhe mallrave/shërbimeve të tjera të nevojshme), për të mundësuar realizimin operacional dhe të pandërprerë të aktiviteteve të përditshme.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e shëndetësisë:

1) Nuk ka kritere efektive për përcaktimin e tarifave kontratuale (limite/buxhete) për institucionet shëndetësore (ISH publike dhe ISH private) dhe për çmimet e shërbimeve shëndetësore dhe barnave, dhe as kritere për përcaktimin dhe alokimin transparent të buxhetit të destinuar për institucionet shëndetësore, për teknologji të reja, për barna dhe metoda për shërbimet shëndetësore;
2) Ka subjektivitet në zgjedhjen e barnave që mbulohen nga fondet publike, përkatësisht nga kontributet e sigurimeve shëndetësore të qytetarëve, ndërsa korniza ligjore e mjekësisë së bazuar në prova nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme;
3) Abuzohet me procedurat për dhënien/pranimin e donacioneve, studimeve klinike dhe projekteve;
4) Praktika joetike të promovimit të barnave;
5) Vendimmarrje jotransparente dhe joobjektive në procedurën për shërim jashtë vendit.

Sqarimi i problemeve:

Nuk ekziston një sistem indikatorësh që përcaktojnë cilësinë, performancën në kohë dhe të plotë të shërbimeve shëndetësore të institucioneve shëndetësore publike. Ai sistem do të ishte në dispozicion të të gjithëve dhe do të shërbente për krahasimin e ndërsjellë të institucioneve shëndetësore, për vlerësimin objektiv nga ana e pacientëve, por edhe për vlerësimin objektiv të buxheteve të nevojshme për funksionimin e vazhdueshëm të institucioneve shëndetësore. Kjo situatë mundëson që personat përgjegjës të ndikohen për sigurimin e fondeve edhe më të mëdha nga FSSH-ja, pavarësisht nga fakti se nuk ofrohen shërbime të mjaftueshme shëndetësore. Për shkak të mungesës së një sistemi të integruar të të dhënave për shpenzimet e institucioneve shëndetësore, ekziston rrezik i madh për subjektivitet në përcaktimin e shpenzimeve hyrëse që ndikon në formimin e çmimit referues të shërbimit shëndetësor. Metodologjia për çmimet e shërbimeve shëndetësore nuk specifikon se kush dhe kur mund të paraqesë një kërkesë për rishikim të çmimit, kështu që të shumtën e rasteve kjo bëhet me kërkesë të institucionit shëndetësor. Nuk ka as kritere për ndarjen e një buxheti të destinuar për teknologjitë dhe barnat e reja, e as për metodat për shërbimet shëndetësore që do të ndiqnin trendet botërore në përputhje me mjekësinë e bazuar në prova. Nuk ka mekanizma funksionalë për kontrollin e çmimeve dhe prokurimin e barnave të patentuara (të ashtuquajturat "brende") dhe barnave për të cilat ekziston vetëm një ilaç i regjistruar dhe i disponueshëm në vend. ***Prandaj, është e nevojshme të vendoset transparencë dhe kritere efektive për ndarjen e buxhetit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore sipas llojit të shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve, forcimi kapaciteteve të Fondit për planifikim, analitikë dhe ekonomi shëndetësore, sigurimi i një mënyre gjithëpërfshirëse të ndarjes të buxhetit sipas niveleve dhe fushave të kujdesit shëndetësor me përfaqësuesit e ISH-ve, përcaktimi i kritereve për ndarjen e buxhetit të destinuar për teknologjitë dhe barnat e reja, metodat e shërbimeve shëndetësore, si dhe dixhitalizimi dhe ndërlidhja e ofruesve të shërbimeve shëndetësore në një sistem të përbashkët kontabiliteti financiar. Është e domosdoshme që sistemi për formimin e çmimeve dhe prokurimet publike të harmonizohet në specifikat e barnave me pozitë monopoli në treg, në përputhje me praktikat dhe rregulloret në vendet e zhvilluara.***

Për shkak të funksionalitetit të pamjaftueshëm të rregulloreve aktuale, ekziston rreziku për veprime korruptive në përcaktimin e barnave që do të jenë pjesë e listës pozitive. Shumë nga protokollet dhe udhëzimet e miratuara në nivel shtetëror për trajtimin e sëmundjeve të caktuara nuk janë të azhurnuara dhe funksionale. Ka kornizë ligjore për mjekësi të bazuar në prova, por nuk ka mekanizma (stimuj dhe gjobitje) për zbatimin e saj. Kjo hap mundësinë për zgjedhjen personale të mjekut për aplikimin e metodave të trajtimit, si dhe favorizimin nga një kolegjium profesional. ***Është e nevojshme të përgatitet një kornizë ligjore për përzgjedhjen e barnave që do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe të sigurohet transparencë në zbatimin e programeve të Ministrisë***

së Shëndetësisë, të cilat përfshijnë edhe sigurimin e barnave. Të inkurajohet zbatimi i përpiktë i parimeve të mjekësisë së bazuar në prova.

Ndodh shpesh të pranohet një donacion me pajisje, që në thelb nuk ka ndonjë karakteristikë dhurimi, sepse në fakt mundëson një përfitim të drejtpërdrejtë për donatorin në të ardhmen. Ndodh gjithashtu që të pranohet një donacion i cili për shkak të teknologjisë së vjetëruar nënkupton shpenzime të mëdha financiare për mirëmbajtje, apo edhe një donacion i cili për shkak të afateve, mund të shkaktojë shpenzime për trajtimin e mbeturinave mjekësore. Nuk ka asnjë regjistër të studimeve klinike ose të dhëna të tjera publike lidhur me donacionet e barnave dhe pajisjeve. Kjo situatë mundëson abuzime me marrëveshjet për pranimin e donacioneve, ***kështu që është e domosdoshme të specifikohen karakteristikat, kushtet dhe mënyra e pranimit të donacioneve në institucionet shëndetësore publike, dhe në të njëjtën kohë të dhënat për donacionet e barnave, pajisjeve dhe studimeve klinike të jenë në dispozicion të publikut.***

Për nga natyra vet, promovimi i barnave paraqet një ndërveprim mes industrisë farmaceutike dhe mjekëve, dhe si i tillë është thelbësor për zhvillimin e ilaçeve, edukimin e vazhdueshëm mjekësor dhe monitorimin e efekteve anësore. Sidoqoftë, për shkak të mekanizmave të dobët rregullues në këtë fushë, veçanërisht në fushën e gjobitjes, janë vërejtur praktika korruptive në formë të pagesave direkte dhe indirekte për mjekët dhe farmacistët që përshkruajnë barna të kompanive farmaceutike. Përveç përfitimeve të paligjshme materiale, kjo ekspozon buxhetin e shtetit në shpenzime irracionale, si dhe buxhetin shtëpiak të përdoruesve të ilaçeve. Integriteti profesional i mjekëve dhe personelit mjekësor është gjithashtu i cenuar. Vendi nuk ka një sistem të vendosur të "komisioneve terapeutike" dhe "regjistrave spitalorë të barnave" në nivel spitalesh, detyra e të cilëve do të ishte të vendosnin objektivisht se cilat ilaçe do të përdoren në cilin spital përkatës, bazuar në parametrat mjekësorë dhe ekonomikë. Për të tejkaluar këtë situatë, është e domosdoshme ***të definohen dhe të monitorohen marrëdhëniet ndërmjet kompanive farmaceutike dhe mjekëve në lidhje me promovimin e barnave. Në nivel spitali është e nevojshme të vendoset një sistem i "komisioneve terapeutike" dhe "regjistrave spitalorë të barnave".***

, Për shkak të mungesës së stafit të profilizuar, pajisjeve adekuate ose teknikave të pazbatueshme në shëndetin tonë publik, shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore shpeshherë detyrohen të kërkojnë shërbime trajtimi jashtë vendit. Sigurisht, kjo kërkon aprovimin e fondeve nga buxheti i FSSHRMV-së, që u nënshtrohet procedurave të gjata për aprovim dhe udhëzim në institucion shëndetësor përkatës jashtë vendit. Për një efikasitet më të madh të udhëzimeve për trajtim jashtë vendit, ***është e nevojshme të përcaktohet një listë me spitale referuese, përmes kritereve të përcaktuara qartë, që do të mundësonin sigurimin në kohë të shërbimeve të nevojshme për personin aplikues.***

5.5. ARSIMI

Sektori i arsimit është shumë i gjerë dhe përfshin Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe organet e saj të pavarura, njësitë e vetëqeverisjes lokale (për shkak të kompetencave të decentralizuara në këtë sektor), shkollat fillore dhe të mesme publike, si dhe universitetet shtetërore. Këtu përfshihen edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, përgjegjëse për çerdhet që ofrojnë shërbime të arsimit parashkollor.

Korrupsioni në arsim në raportet përkatëse të korrupsionit trajtohet pak, por ky sektor në sondazhe të ndryshme shpesh potencohet nga qytetarët për perceptimin e tyre ose për përvojën e praktikave korruptive. Ministria e Arsimit nuk bën vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit dhe as nuk përmendet në ndonjë nga dokumentet strategjike në këtë sektor.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e arsimit:

1) Ndikime të theksuara dhe të drejta diskrete në punësimet në arsim;
2) Kapacitete të pamjaftueshme të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit;
3) Vetëdija e ulët për trajtimin e çështjes së korrupsionit brenda institucioneve arsimore;
4) Mungesa e legjislacionit preciz për përdorimin e mjeteve metodike-didaktike mësimore;
5) Mungesa e procedurave për prokurimet të cilat në institucionet edukative-arsimore realizohen jashtë Ligjit për prokurime publike;
6) Mungesa e akteve nënligjore për mënyrën e definimit të dhënies me qira të pronave të patundshme të institucioneve arsimore;
7) Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore;
8) Përmbajtja e pamjaftueshme mbi parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit në procesin arsimor të arsimit të mesëm.

<u>Sqarimi i problemeve:</u>

Ndikime të theksuara dhe të drejta diskrete gjatë punësimeve në arsim ka në të gjitha nivelet e tij. Kur punësohen mësues në arsimin fillor dhe të mesëm, ka kritere të përcaktuara dhe me ligj

parashihet intervistimi i kandidatëve, ndërsa drejtorëve u lejohet të përdorin të drejtën diskrete për të zgjedhur kandidatët bazuar në intervistën e kryer, në rast se kriteret formale i përmbushin më shumë kandidatë. Një problem shtesë është shkarkimi i drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme para skadimit të mandatit, pa shpjegime të duhura dhe nën presion politik. Gjatë zbatimit të procedurave të punësimit, shpesh përdoret mekanizmi për punësimin e përkohshëm të kandidatëve, i cili i paraprin procedurës për punësim të rregullt. Është një mënyrë që në institucion të pranohen kandidatë "të zgjedhur", të cilët pastaj zakonisht favorizohen në procedurën për punësim të rregullt.

Në Ligjin për arsimin e lartë ekzistojnë procedura dhe kritere të përcaktuara për punësimin e personelit mësimdhënës dhe nominimin e titujve mësimorë-shkencorë në arsimin e lartë dhe institucionet shkencore. Vlerësimin e kandidatëve dhe nominimin e propozimeve e bën një komision recensues treanëtarësh, në të cilin dy anëtarë duhet të jenë nga fusha e ngushtë shkencore, ndërsa vendimin përfundimtar e merr këshilli mësimoro-shkencor i institucionit ose senati i universitetit në rast të nominimit për titullin profesor i rregullt. Kjo krijon një mundësi për zbatim më të gjerë të qëndrimeve personale dhe favorizimin e kandidatëve të caktuar nga komisioni. Këshilli/senati nuk është i obliguar ta miratojë propozimin e komisionit recensues, por në praktikë kjo ndodh shumë rrallë .

Për të krijuar një klimë punësimi vetëm në bazë të kompetencave, gjatë punësimeve në arsimin fillor dhe të mesëm është e nevojshme ***të përcaktohen kritere dhe procedura të qarta për intervistimin e mësuesve. Gjithashtu është e nevojshme që vendimet për shkarkimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme para skadimit të mandatit të tyre, të përmbajnë shpjegime të hollësishme dhe ato vendime t'i nënshtrohen inspektimit.*** *Në fushën e arsimit të lartë duhet* ***të vendoset një mekanizëm i mbikëqyrjes së rregullt nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit mbi procedurat e nominimit të ligjëruesve për tituj mësimorë-shkencorë.***

Kapacitetet e pamjaftueshme të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA) paraqesin një problem që kufizon ndjeshëm mundësitë për veprimin e tij. Në fushën e inspektimit, një nga dobësitë kryesore është mungesa e një metodologjie gjithëpërfshirëse për mbikëqyrje nga ISHA-ja. Kjo ndërlidhet edhe me mungesën e vazhdueshme të inspektorëve, veçanërisht lidhur me nevojën për të kryer inspektime të jashtëzakonshme. E gjithë kjo paraqet një rrezik të theksuar për presione, përkatësisht ndikime (partiake, miqësore ose nga palët e treta) lidhur me gjetjet nga inspektimet e kryera. Për të kapërcyer problemet e deklaruara është e nevojshme ***të forcohen kapacitetet materiale dhe teknike, si dhe kapacitetet njerëzore të Inspektoratit; përmes edukimit dhe trajnimit të fuqizohet rezistenca e punonjësve të ISHA-sI nga ndikimet potenciale dhe të avancohen mekanizmat për kontrollimin e punës së inspektorëve.***

Brenda institucioneve arsimore ka **vetëdije të ulët për trajtimin e çështjes së korrupsionit.** Ky problem nuk është i përfshirë në planin strategjik të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në dokumente të tjera përkatëse, e nuk imponohet as nga organet drejtuese të universiteteve. Herë pas here organizohen konferenca dhe debate mbi këtë temë, por nuk ka asnjë dokument ose aktivitet zyrtar. Për të përmirësuar situatën në këtë fushë nevojiten ***fushata dhe aktivitete të sistemuara për të rritur vetëdijësimin për parandalimin e korrupsionit në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe për avancimin e mekanizmave përmes të cilëve studentët dhe profesorët mund të raportojnë korrupsionin.***

Nuk ka një kornizë ligjore enkas për përdorimin e mjeteve mësimore metodike dhe didaktike në arsimin fillor dhe të mesëm. Ligji aktual mbi tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm nuk përcakton qartë se si përcaktohen mjetet mësimore metodike dhe didaktike që përdoren në mësimdhënie, dhe as se si blihen ato. Kjo gjeneron një rrezik të abuzimit me detyrën, përkatësisht studentët mund të detyrohen që të blejnë tekste arsimore nga botues dhe autorë me të cilët punëtori arsimor ka raport të caktuar. Prandaj ***është e nevojshme të përcaktohen kritere të sakta për prokurimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore në shkollat fillore dhe të mesme.***

Mungesa e procedurave të prokurimit që realizohen në institucionet arsimore jashtë Ligjit për prokurime publike. Në institucionet arsimore janë realizuar një numër i madh prokurimesh (ekskursione të nxënësve, sigurimi fizik i shkollës, fotografimi i nxënësve dhe përgatitja e kalendarëve vjetorë të shkollës, prokurimi i ushqimit, sigurimi jetësor i nxënësve etj.), që bëhen jashtë dispozitave të Ligjit për prokurime publike. Ky lloj prokurimi ofron mundësi të shumta për korrupsion dhe abuzim me detyrën, ndërsa shpenzimet i mbulojnë prindërit e nxënësve. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka miratuar një rregullore për organizimin e ekskursioneve, por nuk ka akte nënligjore dhe procedura për llojet e tjera të prokurimeve të kësaj natyre. Në këtë drejtim ***është e nevojshme të përgatiten aktet nënligjore që rregullojnë mënyrën e zbatimit të këtyre prokurimeve në institucionet arsimore.***

Mungesë e akteve nënligjore për mënyrën e definimit të dhënies me qira të pasurive të patundshme të institucioneve arsimore. Qiradhënia e pronave të patundshme të institucioneve arsimore bëhet në mungesë të rregullores adekuate. Në praktikë, shkollat dhe fakultetet japin me qira hapësirat e tyre për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme (hotelierike, sportive etj.), pa procedura të definuara qartë. Prandaj ***është e nevojshme të përgatiten akte nënligjore që do të definojnë dhënien me qira të pronave të patundshme nga institucionet arsimore të të gjitha niveleve***.

Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore. Ligji për arsimin e lartë[17] parashikon krijimin e një këshilli nacional për arsimin e lartë

[17] Gazeta Zyrtare, nr. 82/2018

dhe veprimtari kërkimore-shkencore dhe një agjenci për cilësinë në arsimin e lartë, të cilët do të kenë kompetenca në lidhje me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore. Dispozitat e këtij ligji nuk janë zbatuar akoma, megjithëse Ligji është në fuqi që nga maji i vitit 2018. Ligji definon agjencinë si një "organ të pavarur profesional" me tri organe (bordi i akreditimit, bordi i vlerësimit dhe drejtori i agjencisë). Sipas Ligjit, bordet janë të detyruara që në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Këshillit Nacional t'i dorëzojnë një raport lidhur me punën e tyre, ndërsa drejtori, zgjedhja dhe shkarkimi i të cilit është në mandatin e Kuvendit, nuk është i detyruar të raportojë për punën e agjencisë. Kjo krijon një vijë të paqartë të përgjegjësisë dhe mungesën e mekanizmave të kontrollit dhe njëkohësisht krijon hapësirë të bollshme për ndikime të ndryshme. Për më tepër, ka paqartësi në lidhje me transparencën në zgjedhjen e anëtarëve të agjencisë nga Qeveria dhe kriteret mbi bazën e të cilave Konferenca Ndëruniversitare zgjedh anëtarët e agjencisë dhe një anëtar të bordit studentor për bordin e akreditimit dhe bordin e vlerësimit. Rrjedhimisht domosdoshmërisht duhet që: ***Këshilli Nacional për Arsimin e Lartë dhe Veprimtari kërkimore-Shkencore dhe Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë të jenë funksionale; të ketë ndryshime dhe plotësime në Ligjin për arsimin e lartë me qëllim të saktësimit të përgjegjësisë së Agjencisë për Cilësinë e Arsimit; të sigurohet transparencë e lartë në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve dhe punën e Agjencisë; të ndërmerren aktiviteteve për anëtarësimin e Agjencisë në Rrjetin Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (***në origjinal ***ENKA).***

Përmbajtje e pamjaftueshme mbi parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit në procesin arsimor në arsimin e mesëm. Parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit janë baza për parandalimin e korrupsionit, prandaj është e nevojshme që të rinjtë të edukohen dhe të njihen me këtë fenomen gjatë arsimimit të tyre. Gjatë vitit 2019, KSHPK-ja, në bashkëpunim me organizatën e shoqërisë civile IDSCS, Entin për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, filluan zbatimin e një projekti pilot për edukimin antikorrupsion për nxënësit e shkollave të mesme në 10 shkolla. Nga zbatimi i projektit pritet vazhdimi dhe zgjerimi i programit arsimor në sistemin e arsimit të mesëm, duke përfshirë përmbajtjen antikorrupsion në programet e rregullta. ***Kjo imponon nevojën për përgatitjen dhe për përpilimin e përmbajtjes arsimore antikorrupsion në sistemin e arsimit të mesëm.***

Masat dhe aktivitetet konkrete të sektorit të arsimit janë paraqitur më detalisht në tabelën 5.5. të Planit të Veprimit të kësaj Strategjie.

5.6. PUNA DHE POLITIKA SOCIALE

Sektori i punës dhe politikës sociale mbulon çështje që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe të drejtat sociale, të drejtën për pension dhe sigurim invalidor, si dhe arsimin parashkollor të fëmijëve në çerdhe. Ministri kompetente është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e punës dhe politikës sociale:
1) Mungesë e mbikëqyrjes në procedurat për ushtrimin e të drejtave për pension dhe sigurim invalidor;

<u>Sqarimi i problemeve:</u>

Mungesa e një sistemi të dixhitalizuar të sigurimeve shoqërore dhe mungesa e mbikëqyrjes në procedurat për ushtrimin e të drejtave për pension dhe sigurim invalidor. Në mungesë të një sistemi unik të dixhitalizuar të sigurimeve shoqërore, ekziston rreziku që procesi i ushtrimit të të drejtave të personave të siguruar të abuzohet. Komisioni për vlerësimin e aftësisë punuese pranë Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor që heton, vlerëson dhe jep mendim për të drejtën e pensionit në bazë invaliditeti dhe për të drejta të tjera, përballet me mungesë kuadri. Në të njëjtën kohë, nuk janë përcaktuar kritere të sakta për vendimmarrje, që çon në një numër të madh ankesash/parashtresash në lidhje me funksionimin e tij.

Për hetimin e gjetjeve, vlerësimeve dhe mendimeve për përcaktimin e invaliditetit, përkatësisht paaftësisë për të punuar, komisioni pranë MPPS-së përballet me sfida gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit, ngaqë pavarësisht ekzistimit të një sistemi elektronik të përzgjedhjes, ai mund të ndikohet nga faktori njeri. Për më tepër, ka mungesë kontrolli në llogaritjen e stazhit të të siguruarve, që çon në një rrezik tjetër keqpërdorimi nga punonjësit e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, në vëzhgim të pamjaftueshëm të punës së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor nga ana e MPPS-së, si dhe në mbikëqyrje të dobët mbi procedurat për ushtrimin e të drejtave për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër.

Për të kapërcyer sfidat e mësipërme nevojitet:

- ***Krijimi i një sistemi unik të dixhitalizuar të sigurimeve sociale;***
- ***Themelimi i një organi të ri për ekspertizë/vlerësim të invaliditetit/aftësisë për të punuar, i cili do të formohet nga më shumë komisione që do të kryejnë ekspertizë/vlerësim të gjetjeve mbi aftësinë për punë, në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e korrupsionit;***

- ***Ndryshimi i rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së komisionit për hetimin e gjetjeve, vlerësimeve dhe mendimeve për përcaktimin e invaliditetit, a paaftësisë për punë, në pjesën e procedurës për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të tij; dhe***
- ***Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për ushtrimin e të drejtave pensionale dhe sigurimit invalidor.***
- ***Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për ushtrimin e të drejtave për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër.***

Masat dhe aktivitetet konkrete në sektorin e punës dhe politikës sociale janë paraqitur më detalisht në tabelën 5.6 të Planit të Veprimit të kësaj strategjie.

5.7. URBANIZMI DHE PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Sektori i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në kontekstin e kësaj strategjie përbëhet nga institucione publike që janë pjesë e pushtetit qendror dhe lokal, me kompetencë për çështje në fushën e urbanizmit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Këtu fillimisht përfshihen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (MTL), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), organet e pavarura brenda tyre, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Korniza ligjore për punët në fushën e ndërtimit, urbanizmit dhe planifikimit hapësinor parashikon dhënien e lejeve, vendimeve, vërtetimeve, licencave dhe dokumenteve tjera. Rëndësia e këtyre dokumenteve që miraton ky sektor është edhe më e madhe kur dihet botërisht se punët ndërtimore zakonisht kushtojnë shumë, lënë hapësirë për presione, ndikime dhe nxitje të sjelljeve korruptive. Për atë arsye, dhënia e dokumenteve të ndryshme si dhe inspektimet përkatëse konsiderohen si pika që mund të gjenerojnë rrezik korrupsioni në këtë sektor.

Duhet të theksohet se Ligji për përcaktimin e statusit ligjor të ndërtimeve pa leje rrezikon parimet e sundimit të ligjit, zhvillimin e planifikuar hapësinor dhe respektimin e së drejtës së qytetarëve të garantuar me kushtetutë për rregullimin dhe humanizimin e hapësirës, si dhe mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe natyrës, që rrjedhimisht imponon nevojën që sa më shpejt të kufizohet zbatimi i tij.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit urban:

1) Mbikëqyrja e pamjaftueshme e ndërtimeve të kategorisë së dytë.

Sqarimi i problemeve:

Në periudhën shtator-dhjetor të vitit 2019, në procesin e hartimit të kësaj strategjie nacionale, në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor KSHPK-ja vuri në dukje disa probleme në drejtim të mbizotërimit të interesit privat mbi atë publik gjatë miratimit të planeve detale urbanistike, ridestinimit të tokës ndërtimore nga *D1–park i gjelbër* në një kategori tjetër, jotransparencën gjatë miratimit të planeve detale urbanistike të reja ose ndryshimin e planeve ekzistuese dhe të ngjashme. Për shkak se në shkurt të vitit 2020 u miratua një ligj i ri për planifikimin hapësinor dhe urbanistik i cili mundësoi forcimin e standardeve për planifikim hapësinor dhe urbanistik në favor të interesit publik, ai imponoi analizat e detyrueshme në përgatitjen e dokumentacionit të planifikimit urban, bëri definimin e objekteve me rëndësi të veçantë shtetërore, si dhe përcaktoi nevojën për inklusivitet dhe transparencë në procesin e miratimit të planeve urbanistike. KSHPK-ja do të lërë

hapësirë për të monitoruar zbatimin e dispozitave të reja dhe për të regjistruar efektet nga zbatimi i tyre.

Në ndërtim ndodh gjithmonë që një pjesë e ndërtimit të mos kryhet në përputhje me dokumentacionin teknik ndërtimor të aprovuar. Kjo sidomos vlen për ndërtesat e kategorisë së dytë, për të cilat nuk jepet leje shfrytëzimi dhe për të cilat kontrolli teknik kryhet nga një person juridik që ka licencë për mbikëqyrje. Sipas Ligjit për ndërtim[18], licenca për mbikëqyrje revokohet nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nëse personi juridik mbikëqyrës përgatit ose verifikon një raport me shkrim me konstatime që nuk korrespondojnë me gjendjen aktuale të ndërtimit, bazuar në propozimin e një inspektori ndërtimi apo inspektori të autorizuar për ndërtim. Duke marrë parasysh që kjo masë nuk ka zbatim praktik, ***shërbimet e inspektimit janë të obliguara që të fillojnë një procedurë për heqjen e licencës për mbikëqyrje subjektit juridik përkatës, nëse konstatohet që ky subjekt ka paraqitur gjendje të rrejshme në terren (neni 38 paragrafët 5 dhe 6 të Ligjit për ndërtimin)***.

Masat dhe aktivitetet konkrete në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor janë paraqitur më detalisht në tabelën 5.7. të Planit të Veprimit të kësaj strategjie.

[18] Ligji për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" , nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 31/16, 39/16, 71/16, 132/16, 35/18, 64/18 dhe 168/18, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 244/19, 18/20 dhe 279/20)

5.8. MJEDISI JETËSOR

Sektori i mjedisit në kontekstin e kësaj strategjie përbëhet nga institucione publike që janë pjesë e pushtetit qendror dhe lokal, me kompetenca për çështje në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Këtu përfshihen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe organet e saj të pavarura, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe institucione të tjera publike që kanë një rol të caktuar brenda fushëveprimit të sektorit të mbrojtjes së mjedisit, që mbulon cilësinë e ajrit, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma, menaxhimin e mbeturinave, bateritë dhe akumulatorët, menaxhimin e ambalazhimit dhe mbeturinave të paketimit, menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike, ujërat, planifikimin hapësinor, organizmat e modifikuar gjenetikisht, trashëgiminë natyrore dhe kulturore etj. Viteve të fundit ky sektor ka peshë më të madhe për shkak të lejeve të ndryshme ekologjike dhe lejeve tjera që subjektet afariste duhet t'i kenë për të filluar aktivitetet e tyre operacionale.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e mjedisit jetësor:

1) Mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin rajonal të mbeturinave;

<u>Sqarimi i problemeve:</u>

Një problem akut me të cilin përballet ky sektor është zbatimi jokonsistent i Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, në drejtim të menaxhimit të integruar dhe rajonal të mbeturinave. Kjo gjendje është pasojë e interesave të ngushta partiake, sepse krijimi i qendrave rajonale për menaxhimin e mbeturinave do të zvogëlojë kompetencat e ndërmarrjeve publike komunale. Kjo do të zvogëlonte mundësinë e përdorimit të këtyre ndërmarrjeve për qëllime partiake, veçanërisht në fushën e punësimeve. Nga ana tjetër, shërbimet publike komunale në përgjithësi janë në gjendje shumë të keqe dhe janë joefikase në menaxhimin e mbeturinave, që rezulton me degradim serioz të mjedisit. ***Prandaj është e domosdoshme të krijohen qendra rajonale funksionale të menaxhimit të mbeturinave sa më shpejt të jetë e mundur.***

5.9. BUJQËSIA

Sektori i bujqësisë në kontekstin e kësaj strategjie përbëhet nga institucione publike me kompetenca për çështje në fushën e bujqësisë, para së gjithash nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave–MBPEU, Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural–AMFBZHR dhe Agjencia për Stimulimin e Zhvillimit të Bujqësisë-Manastir ASZHB.

Viteve të fundit, përmes krijimit të politikave për mbështetje të bujqësinë Qeveria ndan një pjesë të konsiderueshme të buxhetit për të stimuluar dhe për të kultivuar prodhime bujqësore, por mbizotëron mendimi se efektet e këtyre masave nuk kanë përmbushur rezultatet e pritura, kryesisht për shkak të menaxhimit dhe zbatimit joefikas të politikave.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e bujqësisë:

1) Ridefinimi i sistemit për shitjen e tokës bujqësore shtetërore dhe vendosja e mbikëqyrjes efektive për mënyrën dhe respektimin e kontratave për shfrytëzimin e tokës bujqësore shtetërore;
2) Ndryshimet e shpeshta ligjore dhe kriteret e pasakta për dhënien e subvencioneve;
3) Numri i pamjaftueshëm i punonjësve dhe arsimimi i tyre, ndihma e pamjaftueshme për referimin e qytetarëve, jotransparenca e procedurave;
4) Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave, zbatimi i politikave dhe mbikëqyrja e tyre në sektorin ushqimor;
5) Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave, zbatimi i politikave dhe mbikëqyrja e tyre në fushën e mjekësisë veterinare;

Sqarimi i problemeve:

Korniza ligjore për veprimtari në fushën e bujqësisë ka për qëllim krijimin e politikave, të cilat, ndër të tjera, i referohen dhënies me qira të tokës bujqësore për një periudhë më të gjatë dhe pagesës së subvencioneve të ndryshme me qëllim stimulimin e prodhimit bujqësor.

Për shkak të mungesës së mbikëqyrjes adekuate të inspektimit, nuk mbikëqyret mënyra e shfrytëzimit të tokës dhe respektimi i kontratave për shfrytëzimin e tokës shtetërore bujqësore nga shfrytëzuesit. Si rezultat i kësaj, nuk ka evidencë të plotë të qirave, nuk janë marrë masa të arkëtimit të detyrimeve nga shfrytëzuesit dhe nuk janë shqiptuar sanksione për to.

Ndryshimet e shpeshta në rregullore krijojnë pasiguri ligjore dhe mundësi favorizimi të një grupi të caktuar. Numri i madh i masave për të stimuluar zhvillimin e bujqësisë, kriteret e pasakta dhe

ndryshimet e tyre të shpeshta që nuk korrespondojnë me sistemet e vendosura të kontrollit (regjistrat dhe evidencat), nuk çojnë në arritjen e objektivave të përcaktuar të politikave bujqësore ose janë masa ad hoc për të kënaqur një grup të caktuar. Kjo krijon rreziqe për sjellje korruptive të personave përgjegjës që marrin pjesë në procedurat për ndarjen e këtyre fondeve, përqendrim të vendimmarrjes te një numër i vogël personash, krijon klientelizëm dhe favorizimin e personave të afërt dhe të një numri të vogël të ndërmarrjeve që shfrytëzojnë këto resurse.

Përveç kësaj, edhe numri i pamjaftueshëm i punonjësve, niveli i ulët i arsimimit, mungesa e ndihmës dhe këshillimit të qytetarëve për masat dhe procedurat për shfrytëzimin e mbështetjes shtetërore, resurset e pamjaftueshme financiare ndikojnë që vendimi lidhur me kërkesat të mos jetë transparent dhe të zgjasë më shumë se afatet e parashikuara me ligj.

Për të tejkaluar këto probleme nevojitet: ***forcimi i mbikëqyrjes mbi mënyrën e shfrytëzimit të tokës dhe përgatitja e kontratave për qira të tokës bujqësore ku do të përcaktohen procedurat e hollësishme për mbikëqyrje dhe sanksionet; rishikimi i rregullave për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore përmes një organi të pavarur; hartimi i masave dhe politikave të reja mbështetëse që do të bazohen në parimet e mbrojtjes së mjedisit; vendosja e praktikave të mira bujqësore, prodhimi i ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt; subvencione ekonomikisht të arsyeshme; vendosja e indikatorëve për monitorimin e efekteve nga masat e mbështetjes financiare; forcimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve për veprim të shpejtë dhe profesional lidhur me kërkesat; rritja e transparencës së procedurave dhe informimi i shfrytëzuesve të mundshëm me të dhëna relevante për qasje më të lehtë te këto fonde.***

Ligji për sigurinë e ushqimit, Ligji për sigurinë e ushqimit të kafshëve, Ligji për mjekësinë veterinare, Ligji për produktet mjekësore veterinare, Ligji për nënproduktet me origjinë shtazore, Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve – janë zgjidhje ligjore që mundësojnë përqendrimin e kompetencave në një organ. Krijimi dhe miratimi i politikave në këto fusha, si dhe zbatimi dhe mbikëqyrja janë përgjegjësi e një organi. ***Për atë arsye, është e nevojshme që kompetencat për miratimin dhe zbatimin e politikave të organeve përkatëse të jenë të përkufizura qartë, si dhe të formohet një organ i veçantë për inspektim ose për inkorporimin e tij në kuadër të Inspektoratit Shtetëror për Bujqësi.***

5.9. SPORTI

Sporti është një segment i jetës shoqërore që ka një rëndësi të madhe për shëndetin psiko-fizik të qytetarëve, por gjithashtu ka një ndikim të madh sociologjik në të gjithë komunitetin. Sporti ka potencial të fuqishëm për të promovuar vendin në botë. Ky sektor trajtohet në këtë strategji për shkak të rrezikut për korrupsion në fushën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe njësive të vetëqeverisjes lokale, por edhe në fushën e veprimtarisë sportive, e cila realizohet përmes federatave dhe klubeve sportive si anëtarë të këtyre federatave. Duke pasur parasysh investimet e mëdha të shtetit në objektet sportive dhe rëndësinë e tyre për sportin në përgjithësi, administrimi i asaj prone është një fushë që prek seriozisht interesin publik. Kjo imponon nevojën për rregullim optimal normativ të marrëdhënieve për sa i përket pronësisë, disponueshmërisë dhe shfrytëzimit të objekteve sportive. Në të njëjtën kohë, pushteti qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë për obligim të sigurojnë kushte që veprimtaria sportive të realizohet brenda ligjit dhe praktikave pozitive.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sferën e sportit:

1) Menaxhimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja joadekuate e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njësive të vetëqeverisjes lokale;
2) Mungesa e inspektimit në sport.

<u>Sqarimi i problemeve:</u>

Objektet sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në pronësi të njësive të vetëqeverisjes lokale **shpeshherë përdoren për marketing politik, manipulime dhe përvetësime të paligjshme të pasurisë**. Disa nga këto objekte janë dhënë me qira për 20-30 vite, pa justifikim ligjor dhe arsyeshmëri ekonomike. Në to nuk investohet për mirëmbajtje, gjë që rezulton me amortizimin e përditshëm dhe rënien e vlerës së tyre. Nga ana tjetër, sportistët, klubet dhe federatat nacionale të sporteve u bënë qiramarrës në objektet e ndërtuara për ta. Decentralizimi i papërfunduar në lidhje me objektet sportive dhe paqartësia e legjislacionit për pronësinë e tyre janë një bazë tjetër për manipulimin dhe eksploatimin e pakontrolluar të këtyre objekteve. ***Prandaj është e domosdoshme që të miratohet menjëherë një strategji për objektet sportive në pronësi shtetërore, me çka do të krijohet një koncept i qartë për këto hapësira. Po ashtu është e nevojshme të rishikohet situata aktuale me objektet sportive dhe të rishikohen kontratat për shfrytëzimin e tyre.***

Sporti, me rrjetin e tij të klubeve sportive, federatave nacionale të sporteve, asociacionet komunale të sporteve, objektet sportive të tipit të hapur dhe të mbyllur, **nuk ka shërbim adekuat inspektimi,**

sepse operon me një numër të kufizuar inspektorësh. Mungesa e inspektimit efektiv në sport rezulton me dukuri devijuese serioze, të cilat janë veçanërisht të theksuara në pjesën e menaxhimit të objekteve sportive në pronësi shtetërore, por edhe në funksionimin e federatave nacionale të sporteve. Shteti ndan shumë mjete buxheti për të mbështetur punën e federatave sportive, por ato nuk përdoren gjithmonë në mënyrë efektive dhe për të mirën e sportistëve. ***Prandaj, duhet të vendosen inspektime efektive në sport dhe objekte sportive, si dhe të mundësohet edukimi adekuat lidhur me integritetin dhe etikën e federatave sportive, klubeve dhe administrimin e tyre.***

5.10. EKONOMIA DHE BIZNESI

Sektori i ekonomisë në kontekstin e kësaj strategjie përbëhet nga institucione publike që janë pjesë e pushtetit ekzekutiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kompetenca për çështje ekonomike. Këtu para së gjithash përfshihet Ministria e Ekonomisë (ME) dhe organet e saj të pavarura, si dhe institucione të tjera publike që kanë një rol të caktuar në lidhje me politikat ekonomike. Gjithashtu, ky sektor përfshin subjektet afariste, sidomos përsa i përket ndërveprimit të biznesit me sektorin publik. Rreziqet për korrupsion në sektorin e ekonomisë lidhen kryesisht me vendime të ndryshme, leje, marrëveshje koncesioni dhe dokumente të tjera, që janë kryesisht në kompetencat e Ministrisë së Ekonomisë ose institucioneve të tjera. Korniza ligjore për veprimtarinë e shumë subjekteve ekonomike dhe personave fizikë që kryejnë një veprimtari të caktuar në mënyrë të pavarur parasheh rregullimin e statusit të tyre me një nga dokumentet që përmenden aty. Për më tepër, në sektorin e ekonomisë si rreziqe për korrupsion identifikohen edhe prokurimet publike, inspektimi dhe punësimi në institucionet publike, të cilat janë trajtuar më hollësisht në pjesët përkatëse të kësaj strategjie që mbulon këto çështje.

Në vazhdim janë dhënë probleme kryesore në sektorin e ekonomisë dhe biznesit:

1) Mosekzistimi i një regjistri të ndihmave shtetërore për operatorët ekonomikë në pronësi të subjekteve juridike vendase dhe të huaja;
2) Dhënia e tepërt e koncesioneve, transparenca e pamjaftueshme e marrëveshjeve për koncesione dhe mekanizmat jomjaftueshëm të zhvilluar për përcaktimin e tarifës reale të koncesioneve për eksploatimin e lëndëve të para;
3) Mosekzistimi i regjistrave të pronave në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NJVL-ve;
4) Përfshirja e pamjaftueshme e subjekteve më të vogla ekonomike në procesin e krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera të rëndësishme për komunitetin afarist.

Sqarim.i i problemeve:

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka asnjë regjistër të vetëm të ndihmës shtetërore të dhënë, i cili do të siguronte informacion të hollësishëm, monitorim të azhurnuar dhe të pandërprerë të situatës në lidhje me ndihmat shtetërore në vend. Sipas rregulloreve ekzistuese për ndihmën shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) ka detyrim të publikojë një raport vjetor me të dhëna përmbledhëse (kumulative) lidhur me ndihmat e dhëna në vitin përkatës, bazuar tek informacionet e siguruara nga institucionet që japin ndihmë shtetërore. Mirëpo mundësia për sigurimin e të dhënave në kohë reale nuk ekziston. Informacione muk mund të

sigurohen as nga përfituesit e ndihmës shtetërore, që pamundëson qasjen e qytetarëve dhe palëve të interesit në pasqyrën e plotë të ndihmave të dhëna. Si pasojë, nuk ka asnjë mundësi për të analizuar efektet e asaj ndihme, nuk mund të shihet nëse ndihma është dhënë në mënyrë të drejtë etj. Kjo ndërlikon punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili e ka detyrim ta kontrollojë arsyeshmërinë e ndihmës së dhënë dhe ta miratojë atë. Këtu ekziston një rrezik i lartë për korrupsion, duke qenë se shuma totale vjetore e ndihmës shtetërore në vitin 2018 ishte rreth 40 milion euro për kompanitë vendase dhe rreth 15 milion euro për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë të huaj[19]. ***Për të përmirësuar situatën në këtë fushë, KMK-ja duhet të krijojë, të plotësojë, të publikojë dhe të azhurnojë regjistrin me informacione për secilën formë të ndihmës së dhënë shtetërore.***

Ekziston një përdorim i tepërt i burimeve natyrore të shtetit përmes dhënies së koncesioneve, që nga ana tjetër rrezikon mjedisin dhe qëndrueshmërinë e biodiversitetit. **Nuk ka transparencë të mjaftueshme për marrëveshjet e koncesionit, e as mekanizma të zhvilluar në mënyrë adekuate për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për eksploatimin e lëndëve t**ë **para.** Në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë ka regjistra të koncesioneve të dhëna dhe kontrata koncesionare për burimet minerale[20], por regjistri i kontratave përmban vetëm të dhëna për poseduesin e koncesionit (kompaninë) dhe lëndën e parë që eksploatohet, ndërsa kontratat e plota nuk bëhen publike, kështu që nuk ka asnjë mundësi për të parë kushtet e koncesionit që iu janë dhënë poseduesve të koncesionit. Për më tepër, mekanizmat për përcaktimin dhe mbledhjen e tarifës aktuale të koncesionit nuk janë zhvilluar aq sa duhet. Çdo koncesion nënkupton pagimin e tarifës së përcaktuar në dy këste – një shumë e fiksuar që paguhet çdo vit (përcaktohet gjatë dhënies së koncesionit) dhe kësti i dytë sipas sasisë së lëndës së parë të eksploatuar. Vetë koncesionarët raportojnë sasinë e eksploatuar te ministria përkatëse, zakonisht i përcjellë me një raport gjeodezik ose shtojcë tjetër adekuate, por dhënësit e koncesioneve nuk kanë krijuar një praktikë kontrolli të vërtetësisë së sasive të raportuara të lëndës së parë të eksploatuar. Mungesa e mekanizmave të kontrollit për sasitë e lëndës së parë të eksploatuar gjeneron një rrezik korrupsioni. Për të kapërcyer këto probleme është e nevojshme ***të përgatitet një studim i fizibilitetit për të përcaktuar gjendjen e vërtetë me përdorimin e burimeve natyrore në fusha të ndryshme dhe për të krijuar politika dhe masa të reja; rritja e transparencës së koncesioneve të dhëna, duke publikuar kontratat e koncesionit; zhvillimi i mekanizmave për përcaktimin e shumës dhe mbledhjen e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të eksploatuara dhe rritja e kontrollit gjatë eksploatimit të lëndëve të para pas dhënies së koncesioneve.*** Në Republikën e Maqedonisë së Veriut **nuk ka regjistër të pronave shtetërore, e as nuk ka informacione të sistematizuara për mënyrën në të cilën menaxhohet dhe**

[19] http://kzk.gov.mk/годишен-извештај-2018/
[20] http://www.economy.gov.mk/docs/registri

disponohet me atë pronë. Kjo jep një mundësi të gjerë për menaxhim joracional të pronës së shtetit. Në lidhje me pronat e patundshme shtetërore, Ligji për shfrytëzimin dhe disponimin e pronave dhe sendeve shtetërore dhe komunale[21] parasheh që Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, duke u bazuar në numrin unik të identifikimit (NUI), të krijojë një evidencë unike për pasuritë e patundshme shtetërore, si dhe për pasuritë e patundshme në pronësi të shtetit që shfrytëzohen nga organet shtetërore dhe subjektet juridike të themeluara nga shteti.

Në lidhje me sendet e tundshme, në përputhje me nenin 2 të Ligjit për përdorimin dhe disponimin e pronave dhe sendeve në pronësi të shtetit dhe komunave, termi sende dhe pajisje të tundshme nënkupton: pajisjet e komunikacionit dhe komunikimit, mjetet dhe pajisjet speciale dhe universale, armët, mjetet dhe pajisjet që kanë për qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Maqedonisë, pajisjet për mobilimin dhe mirëmbajtjen e zyrave dhe hapësirave të tjera, për kryerjen e shërbimeve teknike, afariste, financiare dhe shërbimeve të tjera, dokumentacione projektesh, programet softuerike, pasuritë jomateriale afatgjata dhe pasuritë e tjera të papërmendura që përdoren si mjete afatgjata për kryerjen e punëve dhe detyrave brenda dhe jashtë vendit, si dhe sendet e tundshme që i kanë në pronësi organet shtetërore dhe subjektet juridike të themeluara nga shteti me fonde nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga procedurat e falimentimit, procedurat gjyqësore, në bazë të arkëtimit të borxheve, nga kreditë e dhëna, ndihma financiare nga jashtë ose përmes donacioneve, në përputhje me mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjet për hua, përkatësisht marrëveshjet për ndihmë ekonomike nga jashtë, respektivisht marrëveshjet për donacione. Duke pasur parasysh njohuritë e deritanishme për keqpërdorimet e automjeteve zyrtare të organeve shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, ***imponohet nevoja për kontroll të shtuar të përdorimit të tyre.*** Kjo situatë mund të kapërcehet vetëm duke vendosur një sistem evidence gjithëpërfshirës dhe transparent të këtyre automjeteve. Në këtë drejtim është e nevojshme ***të azhurnohet regjistri ekzistues i automjeteve motorike në pronësi të institucioneve shtetërore i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe po ai regjistër të avancohet me mundësinë që të dhënat të jenë në dispozicion të publikut dhe të mund të bëhen kërkime të lehta dhe praktike nga institucionet që kërkojnë informacion të caktuar.***

Për të tejkaluar gjendjen e mësipërme në fushën e pronave të patundshme është e nevojshme ***të azhurnohen regjistrat e pasurive të patundshme shtetërore, si dhe pasuritë e patundshme në pronësi të shtetit të shfrytëzuara nga organet shtetërore dhe personat juridikë të formuar nga shteti, përmes përdorimit të numrin unik të identifikimit (NUI) për organet shtetërore, të sigurohet transparencë me mundësi për kërkim të hapur të pronave shtetërore në portalin distributiv[22], si dhe të avancohet regjistri ekzistues i automjeteve në***

[21] Gazeta Zyrtare, nr. 78/2015, 106/2015, 153/2015, 190/2016, 21/2018 dhe 101/2019

[22] https://ossp.katastar.gov.mk/OSSP

Ministrinë e Punëve të Brendshme, me atë që të dhënat të jenë publike dhe të mund të gjenden lehtësisht nga institucionet.

Pjesëmarrja e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla në procesin e krijimit të politikave ekonomike dhe politikave tjera relevante është shumë e vogël. Nuk ka një vetëdije të zhvilluar mjaftueshëm e as mekanizma për të inkurajuar një proces serioz konsultimi me subjekte më të vogla ekonomike. Procesi konsultativ i politikëbërjes, i cili përfshin miratimin e zgjidhjeve ligjore dhe dokumenteve strategjike, shpeshherë kryhet formalisht, pa respektuar afatet e përcaktuara ligjore dhe pa konsultuar të gjithë palët e interesit. Megjithëse ekziston një mundësi ligjore për përfshirjen e ndërmarrjeve të vogla në procesin e konsultimit publik, praktika tregon një nivel të ulët të pjesëmarrjes dhe kontributit në hartimin e politikave. Nga ana tjetër, kompanitë e mëdha dhe afaristët e fuqishëm kanë pozicion të volitshëm për t'u imponuar në procesin e politikëbërjes, që gjeneron një rrezik korrupsioni në kuptimin e miratimit të zgjidhjeve të favorshme për interesa të caktuar biznesi. Për të përmirësuar situatën në këtë fushë është e nevojshme të ***rritet transparenca e procesit të hartimit të politikave dhe të ngritet vetëdijësimi për pjesëmarrjen më aktive të ndërmarrjeve më të vogla në krijimin e politikave ekonomike dhe politikave të tjera të rëndësishme bërjen e biznesit.***

Masat dhe aktivitetet konkrete nga sektori i ekonomisë dhe biznesit janë paraqitur më detalisht në tabelën 5.10 të Planit të Veprimit të kësaj strategjie.

5.11. NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHOQËRITË AKSIONARE NË PRONËSI TË PUSHTETIT QENDROR DHE PUSHTETIT LOKAL

Ndërmarrjet në pronësi dominuese të pushtetit qendror dhe lokal përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë nacionale, përfshijnë sfera me rëndësi strategjike për shtetin dhe qytetarët e tij, disponojnë me shumë mjete, punësojnë një numër të madh njerëzish dhe hyjnë në marrëdhënie bafariste me furnizues të ndryshëm.

Ndërmarrjet në pronë dominuese të pushtetit qendror dhe atij lokal ballafaqohen me rrezik korrupsioni dhe abuzimi për shkak të lidhjeve me strukturat politike, politikave jocilësore të qeverisjes dhe mungesës së transparencës dhe kontrollit.

Në vazhdim janë dhënë problemet kryesore në këtë sektor:

1) Mungesa e informacioneve të unifikuara dhe zyrtare për subjektet juridike në pronësi të shtetit dhe NJVL-ve;
2) Mungesa e një qasjeje sistematike për parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet shtetërore dhe NJVL-të;
3) Korniza ligjore joadekuate për funksionimin e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe NJVL-ve.

Sqarimi i problemeve:

Funksionimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe NJVL-ve (ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare) rregullohet me dy ligje: Ligji për ndërmarrjet publike[23] dhe Ligji për shoqëritë tregtare.

Sipas hulumtimit nga Qendra për Komunikime Civile, në pronësi të plotë të shtetit dhe NJVL-ve janë 145 kompani, të ardhurat vjetore të të cilave tejkalojnë 700 milionë euro dhe të cilat punësojnë mbi 28,000 persona[24]. Sidoqoftë, nuk ka një bazë të vetme të të dhënave zyrtare për të gjithë subjektet juridike të formuara në bazë të ligjeve më lart, në të cilën shteti dhe NJVL-të kanë pronësi të plotë ose aksione pronësie. Mungesa e një baze të vetme publike me të dhëna të pronave të pushtetit qendror dhe pushtetit lokal çon në funksionimin jotransparent dhe mbikëqyrjen joadekuate, e në të kundërtën do të parandaloheshin rreziqet për korrupsion. Sidoqoftë, këto ndërmarrje nuk u përfshinë në programet shtetërore antikorrupsion.

[23] Në periudhën e viteve 1996-2019 Ligji për ndërmarrjet publike është ndryshuar 17 herë

[24] Qendra për Komunikime Civile, Analizë financiare e punës së ndërmarrjeve publike, 2019

Identifikimi i ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe NJVL-ve është një parakusht për zhvillimin e masave të veçanta antikorrupsion. ***Është e nevojshme të përgatitet një regjistër i vetëm i cili duhet të përmbajë të dhëna për ndërmarrjet dhe pjesën e shtetit dhe NJVL-ve.***

Pas procesit të identifikimit të këtyre ndërmarrjeve ***do të përgatitet një program i veçantë antikorrupsion i cili do të synojë forcimin e transparencës, integritetit, përgjegjshmërisë dhe parandalimin e korrupsionit***.

Mangësitë ekzistuese në kornizën ligjore do të tejkalohen *përmes* ***miratimit të një Ligji të veçantë për kompanitë tregtare në pronësi dominuese të shtetit dhe vetëqeverisjes lokale***. Ky ligj, si *lex specialis*, në lidhje me Ligjin për kompanitë tregtare, do të rregullojë mënyrën e zgjedhjes së organeve drejtuese, procedurat e punësimit, transparencën në punë dhe sistemin efikas për mbikëqyrjen e brendshme dhe të jashtme.

5.12. MEDIAT DHE SHOQËRIA CIVILE

Sektori i mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfshin mediat elektronike, të shkruarat dhe mediat në internet. Shumica e mediave rregullohen me Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive[25] dhe Ligjin për media[26]. Agjencia për sShërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive – ASHMAAV është një organ i pavarur që kontrollon punën e mediave elektronike (televizionet dhe radiot)[27]. Korniza ligjore rregullon pothuajse të gjitha çështjet e rëndësishme në këtë fushë, me përjashtim të mediave në internet, të cilat nuk njihen si media dhe nuk ka asnjë legjislacion për evidentimin dhe rregullimin e tyre.

Sektori i shoqërisë civile u referohet organizatave të shoqërisë civile (OSHC) që veprojnë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore. Korniza themelore juridike për OSHC-të përcaktohet me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet[28], ndërsa koordinimi me sektorin publik realizohet përmes Këshillit për Bashkëpunim dhe Zhvillimin e Sektorit Civil[29], të themeluar në vitin 2016, si dhe përmes një rrjeti të nëpunësve civilë për bashkëpunim me sektorin civil.

Mediat dhe organizatat e shoqërisë civile janë palë të rëndësishme në shoqëri, që ndikojnë në opinionin publik dhe janë gjithashtu shfrytëzues të financave publike, dhe kjo mund të gjenerojë rrezik korrupsioni, veçanërisht nëse nuk ka rregulla të përcaktuara saktësisht lidhur me financimin e tyre nga sektori publik.

Në vazhdim janë problemet kryesore në sektorin e mediave dhe shoqërisë civile:

1) Transparenca e pamjaftueshme e institucioneve të sektorit publik për bashkëpunim me mediat, portalet e internetit, agjencitë e marketingut dhe punonjësit e medias;
2) Mungesa e bazës ligjore për rregullimin dhe evidencën e mediave në internet;
3) Forcimi i transparencës së institucioneve në planifikimin e fondeve për financimin e OSHC-ve, si dhe llogaridhënies nga realizimi dhe efektet e projekteve.

Sqarimi i problemeve:

Në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i organeve të administratës shtetërore dhe njësive të vetëqeverisjes lokale në politikën editoriale të mediave, kryesisht për shkak të ndikimit të tyre të

[25] Gazeta Zyrtare, nr. 184/13; 44/14; 101/14; 132/14; 142/16; 132/17; 247/18 dhe 27/19

[26] Gazeta Zyrtare, nr. 184/13 dhe 13/14

[27] https://avmu.mk/

[28] Gazeta Zyrtare, nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016

[29] Vendim i Qeverisë së RMV-së, Gazeta Zyrtare, nr. 98/2016

madh në krijimin e opinionit publik, Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive ndalon çdo reklamim të organeve shtetërore dhe NJVL-ve me mjete nga buxheti i tyre. Një ndalesë e tillë paraqet rrezik që raportimet mbi aktivitetet aktuale (kryesisht në NJVL, shpallje publike, kumtesa...) të paraqiten si premtime të përmbushura (ngjashëm me reklamat parazgjedhore). Bazuar në një vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, u miratua një program[30] me të cilin mediat e shkruara marrin ndihmë shtetërore për të vazhduar së funksionuari. Sidoqoftë, kriteret mbi të cilat jepet një ndihmë e tillë nuk janë aq të qarta dhe mundësojnë keqpërdorimin e fondeve të ndara. Për të tejkaluar këtë gjendje, duhet që ***institucionet e sektorit publik dhe NJVL-të të detyrohen me ligj të publikojnë të gjitha marrëveshjet e kontratuara me të gjitha mediat dhe të forcohen kriteret për dhënien e ndihmës shtetërore për mediat e shkruara.***

Situata aktuale në sektorin e mediave tregon mungesën e (vetë)rregullimit të mediave në internet. Kjo rezulton me funksionimin e tyre të pakontrolluar në hapësirën mediatike, si në drejtim të përmbushjes së standardeve gazetareske profesionale dhe etike, ashtu edhe në lidhje me pronësinë dhe financimin e tyre. Standardet profesionale kryesisht i nënshtrohen vetërregullimit, prandaj respektimi i parimeve gazetareske duhet të vendoset nga përfaqësuesit e profesionit. Për arsyet e mësipërme, organi vetërregullues duhet të mbetet përgjegjës për monitorimin e të gjitha mediave – shtypit, radios, televizionit dhe mediave në internet, pavarësisht nga platforma përmes së cilës ato janë të disponueshme për publikun, por herë pas here duhet të vetëvlerësojë dhe të përcaktojë fushat ku nevojiten përmirësime. Në nivel evropian po bëhen kërkime akoma se si të arrihet një efikasitet më i madh i mekanizmave vetërregullues, ndërsa në RMV publiku beson se rritja e fuqisë së organit vetërregullues mbi mediat në internet do të jetë më efektive sesa rregullimi i tyre me ligj. Vetërregullimi duhet t'i mundësojë publikut të dallojë se cilat media përmbushin kriteret e nevojshme për të funksionuar, cilat i përmbahen kodit gazetaresk në punën e tyre dhe cilat kanë pronësi transparente. Në këtë kontekst ***nevojitet forcimi i vetërregullimit në mediat online dhe azhurnimi i regjistrit të mediave profesionale.***

Modeli aktual i financimit shtetëror të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazohet në një kornizë ligjore që ka disa parametra për planifikimin, hartimin, implementimin dhe monitorimin, si dhe vlerësimin e fondeve shtetërore për OSHC-të. Kur ndajnë fonde për OSHC-të, institucionet kanë në dispozicion edhe kodin joformal të praktikave të mira për mbështetjen financiare të shoqatave qytetare dhe fondacioneve[31]. Si burim financimit më së shpeshti përdoret buxheti qendror, posaçërisht zëri i veçantë i buxhetit *463 – Transfertat tek organizatat joqeveritare*. Praktika tregon një qasje të ndryshme të institucioneve në ndarjen e fondeve për OSHC-të, veçanërisht në lidhje me kriteret për zgjedhjen e OSHC-ve dhe nevojat e institucioneve. Kjo situatë gjeneron një rrezik korrupsioni. Nevoja për të rritur financimin e shtetit

[30] https://vlada.mk/node/19532

[31] https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/kodeks_finansiranje_130_2007.pdf, me qasje **nga data** 15.12.2019

tashmë është vërejtur dhe integruar në "Strategjinë për Bashkëpunim dhe Zhvillimin e Sektorit të Shoqërisë Civile 2018-2020", e cila siguron masa konkrete për të përmirësuar mbështetjen institucionale dhe bashkëfinancimin e projekteve të BE-së të zbatuara nga OSHC-të.

Për të reformuar sistemin e financimit të shtetit dhe për të ofruar mbështetje për organizatat e shoqërisë civile, ***është e nevojshme të forcohet transparenca dhe përgjegjësia në planifikimin dhe zbatimin e fondeve të parashikuara për financimin e OSHC-ve, përmes krijimit të një baze të vetme të të dhënave me informacione mbi fondet e ndara dhe efektet e projekteve që zbatojnë gjitha institucionet shtetërore.***

Masat dhe aktivitetet konkrete të medias dhe sektorit të shoqërisë civile janë paraqitur më detalisht në tabelën 5.12 të Planit të Veprimit të kësaj strategjie.

6. BARTËSIT E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Kjo strategji është dokument i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Bartës i procesit të përgatitjes së Strategjisë dhe koordinimit për zbatimin e saj është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Natyra komplekse e dokumentit, me probleme të identifikuara nga sektorë të ndryshëm dhe masa dhe aktivitete të definuara për tejkalimin e tyre, kërkon planifikim të kujdesshëm të procesit të zbatimit të Strategjisë.

Përveç dy institucioneve kryesore të luftës kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave – Kuvendit dhe KSHPK-së, ka shumë institucione të tjera të përfshira në procesin e zbatimit të Strategjisë. Të gjitha institucionet e radhitura në Planin e Veprimit janë të obliguara të realizojnë masa dhe aktivitete të caktuara. KSHPK-ja duhet t'i koordinojë këto institucione në mënyrë që të marrë informacione në kohën e duhur mbi statusin e masave/aktiviteteve të planifikuara. Në të njëjtën kohë KSHPK-ja paraqitet si bartës i disa masave/aktiviteteve nga Strategjia sepse ka kompetencën për ekzekutimin e tyre. Me qëllim që procesi i koordinimit për zbatimin e Strategjisë të bashkërendohet në mënyrë efikase dhe efektive, ***KSHPK-ja do të përgatisë një plan për mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të dokumentit.***

KSHPK-ja duhet të informojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbaërvajtjen e procesit. Mënyra e komunikimit me Kuvendin definohet me rregullat e përcaktuara të funksionimit të organit më të lartë legjislativ, por informacioni i rregullt do të ishte i dobishëm për të siguruar mbështetje aktive të vazhdueshme nga Kuvendi në luftën kundër korrupsionit.

Për më tepër, zbatimi i Strategjisë duhet të jetë një proces transparent, pra publiku duhet të informohet vazhdimisht për masat/aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e pritura. Strategjia synon të përmirësojë jetën në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke dobësuar kulturën e një shoqërie të korruptuar dhe kufizimet që ajo vendos. Në këtë drejtim komunikimi me publikun për dinamikën e procesit është shumë i rëndësishëm. KSHPK-ja i është përkushtuar transparencës së plotë të procesit dhe angazhohet për zbatimin e Strategjisë.

Një moment tjetër i rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë janë resurset. Në këtë strategji burimet njerëzore janë shtylla më e rëndësishme për sa u përket rezultateve të pritura (forcimi i integritetit të burimeve njerëzore në shumë institucione), si dhe zbatimit të dokumentit. Përveç kapaciteteve njerëzore, resurset materiale janë të nevojshme për mbarëvajtjen e luftës kundër korrupsionit. Në këtë drejtim është e nevojshme të sigurohet mbështetje e plotë për këtë proces, duke u dhënë prioritet aktiviteteve të parashikuara në këtë strategji, sepse rezultatet e luftës kundër korrupsionit janë thelbësore për të çuar përpara shoqërinë maqedonase.

PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË

FUSHAT HORIZONTALE

4.1. PROKURIMET PUBLIKE					
Problemi 1: Numri i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri të standardeve gjatë definimit të specifikacioneve teknike dhe kritereve për përcaktimin e kapacitetit të operatorëve ekonomikë					
Lidhshmëria me qëllimet strategjike të Strategjisë:					
4. Zvogëlimi i korrupsionit në prokurimet publike dhe në procesin e dhënies së granteve, subvencioneve dhe ndihmave të tjera shtetërore					
Masa	**Aktiviteti**	**Institucioni kompetent**	**Afati i realizimit**	**Indikator realizimi**	**Implikime financiare**
1. Avancimi i kapaciteteve të personave që përgatisin dokumentacionin e tenderit	1.1. Konceptimi dhe realizimi i trajnimeve për zbatimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikacioneve teknike dhe kritereve për përcaktimin e kapacitetit me pjesëmarrje të Institutit për Standardizim	Enti për Prokurime Publike Instituti për Standardizim	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	Plan i përcaktuar vjetor për trajnime Numri i trajnimeve të realizuara (në bazë vjetore) Numri i institucioneve që kanë realizuar trajnime (në bazë vjetore)	Ka

4.1. PROKURIMET PUBLIKE					
Problemi 2: Transparenca e pamjaftueshme e institucioneve dhe shkallë e ulët integriteti e personave të përfshirë në realizimin e prokurimeve publike					
Lidhshmëria me qëllimet strategjike të Strategjisë:					
3. Forcimi i integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik					
4. Zvogëlim i korrupsionit në prokurimet publike dhe në procesin e dhënies së granteve, subvencioneve dhe ndihmave tjera shtetërore					
Masa	**Aktiviteti**	**Institucioni kompetent**	**Afati i realizimit**	**Indikator realizimi**	**Implikime financiare**

1. Rritja e integritetit dhe transparencës institucionale në prokurimet publike	1.1. Ndryshim i Ligjit për prokurime publike lidhur me nënshkrimin e detyrueshëm të deklaratës për konfidencialitet nga personat që marrin pjesë në përgatitjen e specifikacionit teknik	Ministria e Financave Enti për Prokurime Publike	Gjysma e parë e vitit 2023	Deklaratë konfidencialiteti në përdorim oficial	Nuk ka
	1.2. Në modelet e dokumenteve të tenderimit që i përgatit, EPP detyrimisht të ceken personat e autorizuar për pranimin e sinjalizimeve të mbrojtura të brendshme dhe të jashtme nga sinjalizues, e në lidhje me korrupsionin në prokurimet publike.	Enti për Prokurime Publike	Gjysma e dytë e vitit 2020	Modele më të kompletuara të dokumenteve të tenderimit me informacione për personat e autorizuar për pranimin e sinjalizimeve të mbrojtura të brendshme dhe të jashtme	Nuk ka
	1.3. Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e informacioneve për prokurimet publike, në bazë të nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik	Agjencia për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	Numri i institucioneve që kanë publikuar informacione lidhur me prokurimet publike, në bazë të nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik	Nuk ka
				Numri i parashtresave të paraqitura për mosrespektimin e nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karater publik, lidhur me prokurimet publike	

				Numri i sanksioneve kundërvajtëse të shqiptuara	

4.2. PUNËSIMET

